E mërkurë, 29 mars 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Pikë së pari, ju kërkoj palëve të prezantohen.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Për Prokurorinë kemi, znjsh. Line Pedersen, menaxheren e rastit; Tim Cebulj, stazhier jurist; Filippo de Minicis dhe Eva Wyler, si dhe unë, Gaia Pergolo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Jam Simon Laws. Përfaqësoj viktimat në këtë çështje gjyqësore bashkë me bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati Mbrojtës, fjala është për ju.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam z.

Gilissen, avokati kryesor. Këtu jemi të z. Pjetër Shala i cili po na ndjek me videolidhje nga objekti i paraburgimit. Këtu është Hedi Aouini, është Leto Cariolou, Dzeneta Petravica, Juliette Healy, Francisca De Castro që janë asistente për rishikimin e provave, Camille Gosson, që është stazhiere edhe Xhulia Tepshi, stazhiere përkthyese. Pra, i njëjti ekip sikurse dhe në seancat e mëparshme. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Për procesverbal, do të dua të them që z. Shala po e ndjek procesin me videolidhje. Dhe do të jap një urdhër me gojë lidhur me këtë.

Trupi Gjykues ka marrë parasysh dëshirën e të akuzuarit për ta ndjekur procesin gjyqësor me videolidhje, çka iu komunikua Trupit Gjyqësor dje me email në orën 06.09 pasdite.

Ne autorizojmë z. Shala që ta ndjekë seancën e sotme dhe nëse dëshiron, çdo seancë tjetër për të gjithë procesin gjyqësor mund ta ndjekë nga objekti i paraburgimit, nëse dëshiron. Trupi Gjykues përfshinë me referencë arsyet që u paraqitën dje. Dhe i referohem transkriptit paraprak faqja 765, rreshti 16, deri në faqen 767, rreshti 16 dhe rikujtoj, në veçanti, se pjesëmarrja me videolidhje nuk e dëmton z. Shala sepse mund t'i ndjekë procesin dhe të komunikojë me avokatin që do të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit dhe e vlerësojmë se kjo mënyrë pjesëmarrjeje ndihmon për të pasur

një zhvillim të drejtë, efikas dhe të shpejtë të procesit gjyqësor.

Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtjen të informojë ZPS-në, Mbrojtësin e Viktimave dhe Zyrën Administrative, si dhe Trupi Gjykues me email nëse z. Shala synon të marrë pjesë në sallën e gjyqit dhe kjo duhet bërë një ditë paraprakisht, në mënyrë që të bëjmë organizimin e nevojshëm apo nëse do të marrë pjesë me videolidhje apo do të jetë i pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit. Kjo mund të bëhet edhe ditën e diel, mund të na komunikoni të dielën për ditën e hënë.

Sa u tha më lart nuk cenon kompetencën e Panelit për të urdhëruar z. Shala të marrë pjesë fizikisht në seancat, kur Trupi Gjykues çmon se është e nevojshme prania e tij fizike ose kur përcaktohet kjo nga rregullorja.

Me këtë mbyll urdhrin me gojë të Trupit Gjykues.

Tani do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitares 06. Edhe e ka radhën Mbrojtësi i Viktimave.

Dje na u desh ta ndërprisnim.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Dëshiroj të them diçka. Sigurisht, nuk komentoj vendimin tuaj. Por mendoj se është e rëndësishme të përpiqemi të shpjegojmë çfarë ndodhi me z. Shala. Sepse unë e pashë mbrëmë, e takova dje në mbrëmje në objektin e paraburgimit dhe kur e pamë - znj. Cariolou ishte me mua, Hedi Auioni ishte me mua - ishte shumë e vështirë të flisje me të. Dhe dje humbëm, sigurisht që z. Shala nuk e

ndoqi më seancën. Më duhet të them që sistemi gjyqësor po ashtu e humbi z. Shala. Është dëshira e z. Shala të jetë i pranishëm dhe ai ishte i pranishëm dhe ai dëshiron të jetë i pranishëm gjatë seancave.

Por ai më shpjegoi dhe unë jam shumë i ndjeshëm, sepse është shumë delikate, më tha arsyen pse. Ai e vlerëson, që jemi të gjithë profesionistë dhe duhet ta mendojmë nga një pikëpamje më e gjerë. Më tha se ajo që ndjeu ai - mbase për mirë apo për keq - ishte shumë e dhimbshme për të, po dëgjonte shumë nga gjërat që nuk po thuheshin në publik domethënë. Ju garantoj, që ai është në dijeni lidhur me nevojën për të respektuar masat mbrojtëse dhe të jemi të drejtë me dëshmitarët. Por ndjesia e tij ishte e tillë sepse ai pati kontakt me ish-partnerët në Belgjikë dhe disa miq dhe të gjithë këta njerëz i thanë, nuk ju ndjekim dot, nuk e përcjellim dot seancën. S’e kuptojmë çfarë po ndodh. Është seancë me copa dhe për publikun është e pamundur të kuptojë. Unë nuk e di nëse është vërtetë, po ky është një informacion që, për mendimin tim, është shumë interesant.

Të gjithë ne këtu e dimë që duhet të respektojmë dhe të mbrojmë dëshmitarët. Sigurisht është një nga kushtet për gjykim të drejtë dhe do të jemi të drejtë me dëshmitarët. Por z. Shala, i cili ka probleme me zemrën dhe ka pasur kriza kardiake, ishte vërtetë nervoz, sepse pasi këtë kontaktin me të njohurit, i krijoi një farë ndjesie të pakëndshme sepse e

kuptoi që nuk po e ndiqte publiku, pra, seanca, gjykimi, nuk ishte publik.

Ai shpjegoi shumë gjëra dhe, vërtetë, z. Shala nuk është i paditur. Ai është një njeri që ka plot dijeni, është i mençur. Edhe unë i kuptova ato që shpjegoi ai, ato që ndjeu ai lidhur me seancën. Nuk është çështja të kritikojmë këtu. Nuk jemi këtu për këtë. Por shkon përtej asaj. Është më interesante. Sepse pata këtë bisedën me z. Shala pas mbrëmjes, unë pata autorizim që ta takoja në burg sepse ishte jashtë orarit zyrtar të vizitave, dhe unë ndoqa pak transkriptin, i hodha një sy transkriptit dhe në fakt, besoj, se z. Shala ka të drejtë. Kemi një problem në këtë pikë. Kur shohim sesi ka shkuar, por e respektoj, dua ta theksoj, e respektoj plotësisht vendimin. Por është për të ardhur keq që e humbëm z. Shala.

Sepse ai dëshiron të jetë i pranishëm. Ai nuk u tërhoq se kishte frikë nga dëshmitarët. Asgjë e tillë jo. Apo se nuk i mbështeste ato çka po thoshin dëshmitarët. Jo, jo nuk ndjehej fare mirë. Dhe mund të pyesim znj. Cariolou dhe z. Aouini, kur e takuam ishte e vështirë të komunikonim me të, sepse kishte vërtetë probleme fizike. Dhe unë mendoj, me gjithë respektin tuaj, më duhet t'ju them që ne duhet ta kemi parasysh këtë parashtrim. E di që në Belgjikë janë përpjekur disa persona ta ndjekin seancën dhe të gjithë më thanë të njëjtën gjë. Sigurisht, ata nuk janë të akuzuarit kuptohet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për parashtrimin tuaj lidhur me këtë pikë.

Shoh znj. Prokurore që u çua në këmbë. A ka lidhje me këtë temë apo keni diçka tjetër?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, unë kisha një aspekt tjetër, por mbase shkurtimisht mund të flas dhe për këtë. Dhe ne e kemi shumë parasysh këto proceset publike dhe jemi përpjekur sa më shumë, të bëjmë të pamundurën në mënyrë që të dëshmitarët t'i marrim në pyetje në publik. Ne e kuptojmë që nuk ka qenë gjithë kohën e mundshme kjo dhe do bëjmë të pamundurën që të mos e përsërisim këtë. Megjithatë, presim edhe udhëzimet e Trupit Gjykues në lidhje me këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, të mbarojmë me këtë aspekt fillimisht ju lutem.

Mbrojtësi i Viktimave, a ka ndonjë gjë që doni të parashtroni ju në lidhje me këtë?

Z. LAWS: [Përkthim] Sigurisht që Gjykata kërkon të gjejë një ekuilibër mes interesave për një gjykim të drejtë po dhe në të njëjtën kohë të mbrojnë dëshmitarët dhe kjo është diçka që nuk do jetë 100 për qind e mundshme gjatë gjithë kohës. Por prioriteti absolut është siguria dhe mbrojtja e atyre që vijnë për të dhënë dëshmi këtu. Edhe nëse kjo kërkon që duhet të kemi seanca private, atëherë ashtu qoftë. Dhe më vjen keq, po ky është produkt i realitetit, ky është realiteti, realiteti i Kosovës për momentin dhe kjo është një temë që është përmendur

shumë herë nga Gjykatës të ndryshëm edhe nga dëshmitarë në këtë Gjykatë.

Pra, këtë duam të themi. Këtë doja të parashtroja unë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokati Mbrojtës, ju e dhatë parashtrimin tuaj, mos e përsërisni, a doni t'i kundërpërgjigjeni Mbrojtësit të Viktimave?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit që më dhatë fjalën.

Duhet të jemi të kujdesshëm dhe të kemi dijeni, të jemi të ndërgjegjshëm më saktë që seanca, një gjykim është shumë delikat. Po një gjykim i drejtë është edhe më shumë se aq, sikurse ju e dini shumë mirë. Edhe më mirë se unë e dini. Unë nuk po përpiqem të jap leksione këtu. Ne këtë e dimë.

Dhe mund të themi gjatë gjithë kohës, oh, të kujdesemi, të jemi të kujdesshëm. Po ka kufi. Një gjyq për të qenë i drejtë duhet të jetë publik, ju lutemi. Prioriteti është një proces publik. Është një garanci. Por sigurisht që duhet të jemi dhe të kujdesshëm sa i takon aspektit të sigurisë, veçanërisht bazuar në të gjithë informacionin lidhur me identifikimin, të dhënat identifikuese për dëshmitarët dhe për sigurinë e tyre. Por përkundrazi, me gjithë respekt, parashtroj dhe e theksoj këtë, seancat publike janë një garanci për gjykimin. Dhe në kundërshtim me Mbrojtësin e

Viktimave, unë them që, jo. Kjo është një gjë shumë e rëndësishme. Këtu duhet të gjejmë ekuilibrin. Dhe ne këtë e dimë shumë, të nderuar Gjykatës. E dimë që është delikate për ju, është punë e vështirë kjo për ju edhe për ne, për palët, pra, pjesëmarrësit në proces. Po nuk duhet të harrojmë parimet edhe parimi është seanca publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë doja që të reagonit. Po unë e kam të qartë parashtrimin tuaj, pikëpamjen tuaj.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Më falni. Këto kisha për të thënë vërtetë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.

Është një pikë e rëndësishme kjo. Edhe dje edhe pardje, ka qenë një nga prioritetet tona që të kishim sa më shumë seanca publike. Po ne, si Trup Gjykues, duhet të gjejmë ekuilibrin mes të drejtave të të akuzuarit, që janë të rëndësishme, pra, dhe parimin e rëndësishëm të një procesi publik dhe nga ana tjetër, sikurse u tha, duhet të kemi parasysh dhe sigurinë dhe mbrojtjen e dëshmitarit. Dhe ne po përpiqemi të bëjmë të pamundurën, aktualisht, që aty ku mundemi seancën ta kemi publike. U kam çuar udhëzime palëve, Mbrojtësit të Viktimave, çdo herë ta kenë parasysh kur bëjnë pyetjen nëse mund ta parashtrojnë në seancë publike apo në seancë private.

Ju rikujtoj se ditën e parë u përpoqëm që sa më shumë të kishim seancën publike dhe patëm shumë redaktime për shkak të kësaj. Po ashtu dua t'ju rikujtoj se një pjesë e kundrapyetjeve, në fakt, u bë po ashtu, kundrapyetjet u bënë në seancë private, kështu që zgjodhët ju. Dhe kjo është një nga arsyet pse të martën u kërkova të gjitha palëve të ishin tepër të kujdesshëm në mënyrën e formulimit të pyetjeve nëse do t'i bënin në seanca publike apo në seanca privat.

Dhe kështu duhet të vazhdojmë duke marrë parasysh të gjitha interesat që luhen këtu. E shpreh edhe një herë, e përsëris, në pikëpamjen tonë dhe bazuar në ligj, prania e z. Shala në këtë sallë gjyqi është ajo që ne parapëlqejmë. Dhe i drejtohem dhe Mbrojtjes, diskutoni dhe njëherë me z. Shala zgjedhjen e tij, vendimin e tij, por që sigurisht që mund të marrë pjesë edhe në distancë, kuptohet, në të njëjtën mënyrë siç do të kishte marrë pjesë po të ishte i pranishëm fizikisht. Edhe pyetja është apo pikëpyetja është a do ta zgjidhim kështu ne këtë ekuilibër, duke mos qenë i pranishëm e zgjidhim ne mungesën e këtij ekuilibri?

Dhe unë këtë po ju a si pyetje ju.

Ne do bëjmë të pamundurën që t'i kemi sa më shumë publike seancat dhe ne, si Trup Gjykues, do përpiqemi t'ju japim edhe më shumë udhëzime në këtë drejtim. Për palët, Mbrojtësin e Viktimave, është edhe përgjegjësia juaj, ju ta vlerësoni nëse është e mundshme apo jo dhe jo vetëm për shkak të një procesi

publik, po të kemi parasysh edhe sigurinë e dëshmitarëve.

Është e vështirë. Është e vështirë në këtë proces, por ne do të përpiqemi ta trajtojmë sa më mirë që të mundemi.

Mirë. Me këtë, pasi thashë këtë, dua të shtoj dhe diçka tjetër. Nëse e kuptojmë që një pjesë e transkriptit që është bërë në privat mund të riklasifikohet si publike, ne do t'i riklasifikojmë si publike. Edhe këtë e kemi bërë dhe me çështjen tjetër. Të bëjmë të pamundurën që t'i japim sa më shumë informacion publikut lidhur me ato që po ndodhin.

Tani mund të vazhdojmë me Dëshmitaren 06. E ka radhën Mbrojtësi i Viktimave për t'i drejtuar pyetjet.

Ndjesë, ju kërkoj ndjesë. Ishte dhe një parashtrim tjetër?

Prokurore, fjala është për ju.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Shkurtimisht. Kjo ka lidhje me urdhrin e parë gojor të Trupit Gjykues që u dha dje gjatë seancës, më duket se ishte në faqen 733 dhe 734 të transkriptit provizor. Ju miratuat kërkesën e Mbrojtjes për zgjatje afati për parashtrim, për dorëzimin e përgjigjeve lidhur me mocionet për dosjet për parashtrimet e protokolluar 463, 465. Dhe kundërpërgjigja për ZPS-në është data 13 prill nga Trupi Gjykues në bazë të vendimit për zhvillimin e procesit.

Rrjedhimisht ne i kërkojmë Trupit Gjykues të na zgjasë dhe ne afatin në përputhje me zgjatjen e afatit që iu miratua

Mbrojtjes lidhur me përgjigjen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Konsiderojeni të miratuar.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Synimi është sigurisht që të respektojmë rregullën 76 dhe kjo vlen për të gjithë, çdo gjë ndryshon në bazë të miratimit të zgjatjes së afatit që u dha për Mbrojtjen.

Asistentja e Gjykatës, a mund të sillni dëshmitaren ju lutem. Faleminderit.

Për qëllime planifikimi, do kemi të njëjtin program si dje. Do punojmë deri në 11.00. 11.30 me 13.00, një orë pushim dhe pastaj 14.00 me 16.00.

[Dëshmitarja vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët.

Mirë se erdhët, znj. Dëshmitare. A më dëgjoni?

DËSHMITARJA: Mirë se ju gjejmë, Shkëlqesia, juaj znj. Kryetare e Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Urojmë të keni pushuar, znj. Dëshmitare.

DËSHMITARJA: Po, mirë shumë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot do të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtësi i Viktimave, aty ku e ndërpremë dje pasdite. Pastaj do të ketë disa pyetje nga ana e

Mbrojtjes. Mirë?

DËSHMITARJA: E kuptueshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani po ia japim fjalën Mbrojtësit të Viktimave.

DËSHMITARJA: TW4-06 [Vijon]

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave: [Vazhdim]

Z. LAWS: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, znj. Dëshmitare.

PË. Mirëmëngjes, gjithashtu.

PY. Dje para se ta mbyllnim, unë doja, domethënë, doja t'ju bëja disa pyetje lidhur me karakterin, tipin e burrit tuaj.

PË. Burri im, sa e vlerësojmë ne, unë si bashkëshorte dhe të gjithë familja, ishte një njeri me të gjitha virtytet njerëzore që ka njeriu. Ishte bashkëshort i mirë dhe prind i mirë.

PY. Faleminderit. Çfarë qëndrimi mbante ndaj ligjit edhe për respektimin e ligjit në përgjithësi?

PË. Mbante qëndrimin e duhur, e respektonte ligjin dhe jashtë ligjit nuk bënte asgjë. Nuk vepronte në asnjë mënyrë.

PY. Faleminderit. Do kaloj tek një pyetje tjetër, do flasim për ndikimin e asaj që ndodhi tek burri juaj. Por do ju bëjë disa pyetje dhe na shpjegoni pasi t'ju bëj pyetjet.

PË. E kuptueshme.

PY. Nuk dua të përsëris ato pasojat fizike sepse këtë e trajtuam mjaftueshëm.

PË. Në rregull.

PY. Po dua t'ju pyes për anën emocionale që pati kjo tek ai, për një moment, për një çast do ju pyes.

PË. Në qasjen emocionale kanë ndikue jashtëzakonisht keq në çdo mënyrë. Si në gjendjen psiqike, si në gjendjen emocionale dhe vazhdimin që e ka fitu sëmundjen, nga të gjitha këto momente ka fitu edhe *[REDAKTUAR]*, trauma dhe trajtime të vazhdueshme mjekësore.

PY. Për sa kohë zgjatën këto pasoja psikologjike pasi e liruan atë nga fabrika e metalit, për sa kohë zgjatën pra?

PË. Kanë zgjatë për disa, për një vit, dy, ashtu. Por më vonë kanë fillue paksa relaksimi. Kur u vu drejtësia dhe punonte, i shihte gjërat që po lëvizin dhe vihet drejtësia në vend, ai kishte një kënaqësi dhe kishte një relaksim që kjo vehet në pah dhe do të dëgjohet çdo kund.

PY. Pak, një çast më përpara ju thatë se merrte mjekim, merrte hapa. Çfarë hapash merrte? Për çfarë mjekohesh?

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

PY. Faleminderit. Sa kohë i mori këto qetësues? Për sa kohë i piu këto hapat qetësuese?

PË. Qetësuese i ka pi për pesë-gjashtë vjet. Pasi u përmirësu pak në shëndet, u ngrit në peshë dhe çdo ditë u relaksonte, u keqësonte por vetëm dhe nëpërmjet të hapave.

PY. Dje përmendët - dhe kjo gjendet në faqen 625 të transkriptit, rreshti 1 deri 2 - thoni që kishte halucinacione pothuajse nga ajo që kishte pësuar; a është e vërtetë?

PË. Po, e vërtetë ishte.

PY. Nëse nuk keni vështirësi, këto halucionacione, këto ëndrra të rënda ishin në lidhje me çfarë?

PË. Këto sa kuptoj ishin dhe ne edhe ai vetë, i kanë ardhë gjithë nga torturat që i janë ba në fabrikën prej personave të përmendur, në fabrikën e metalit. Gjatë natës menjëherë sa i dilte gjumi thoshte "Ku jem?". I thërriste djemtë. I thërriste djemtë "Të vijnë këtu të gjithë t'i shoh". I thojshim "Jemi në shtëpi" "Jemi në dhomë" "Djemtë janë në punë, nuk kanë mundësi me ardhë". Ne jemi të gjithë, ishim unë edhe vajza.
Kështu që gjatë të folurit, gjatë -- kur u ngrinte i gjuante duart, këmbët nga të gjitha këto, nga traumat që kishte. "Ku jem?" thojke. Thosha "Jena në dhomë. Jena në shtëpinë tonë".
Për disa vite kështu e kanë përcjellë këto emocionet.

PY. Faleminderit. Në ka pasur ndonjë ndryshim tjetër në mënyrën sesi e kalonte natën, si flinte gjatë natës?

PË. Edhe njëherë pyetjen, a ban?
PY. Po. A ka ndryshuar ndonjë gjë tjetër lidhur me gjumin e tij pas lirimit nga fabrika e metalit?
PË. Ndonjëherë në bazë të dëgjimit, në bazë të sjelljes së tij edhe bërtite "Ouu", bëjke "Ou" kështu. I thojshna "Pse po bën ashtu? As kurrkush s'po të prek as nuk po të ..." U çonte dhe nuk dinte çka të na thonte tjetër.
PY. A kalonte gjithë natën në shtrat apo ngrihej nga shtrati?
PË. Kur i shihte ato si lloj ëndrrash si, u ngrinte nga shtrati. U ngrihte. U ulte, don të çohej në këmbë. Mirëpo ne gjithmonë i kemi ndejtë pranë, "Ku don me shkue? Ku? A don diku tjetër?" "Jo, vetëm po du qështu me u çue".
PY. Pyetja tjetër e imja është si vijon: Ajo që i ka ndodhur bashkëshortit tuaj, si ka ndikuar tek ti personalisht?
PË. Ka ndikue, shumë momente të vështira. Shumë momente të vështira si nuk mundte t'i numëroj të gjitha ato. Secila në veta ka pasë ndikimin sa më fortë, sa më të vështirë, për mua dhe gjithë familjen, që na ka ndiku edhe neve në emocione, në psiqik, në shëndet dhe në të gjitha këto.
PY. Faleminderit. A mund të na tregoni sesi e kanë perceptuar në komunitet familjen tuaj pas luftës, çfarë mendonin njerëzit rreth e rrotull?
PË. Njerëzit rreth e rrotull e kanë perceptue -- është fjala për ngjarjen që ka ndodhur apo si person?
Një pyetje. Kam edhe një pyetje edhe ndihmën e viktimave, a

bën?

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk e di se cila është pyetja, jam i lumtur që ta dëgjoj pyetjen, po jam në duart e Trupit Gjykues.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, mund ta bëni pyetjen dhe pastaj ne e vendosim nëse i duhet dhënë përgjigje apo jo? Faleminderit.

DËSHMITARJA: Në rregull. A është fjala për burrin si e kanë trajtu, si kanë bisedu njerëzit apo për ngjarjen që na ka ndodhë?

Z. LAWS: [Përkthim]

PY. Pyetja ime kishte të bënte me mënyrën se çfarë mendonin njerëzit për të gjithë familjen pas luftës, pas asaj që i ka ndodhur burrit tuaj dhe ajo që dua të them se është thjesht se çfarë mendonin njerëzit në komunitet për familjen tënde? Çfarë thoshin për familjen tuaj atje? A është kjo pak më qartë si pyetje?

PË. Po. Po. Njerëzit thonin vetëm fjalë të mira. Na vlerësonin sikurse para lufte. Që kemi pasë një vlerësim të mirë nga i gjithë rrethi ku kemi jetu dhe ku kem qëndrue, sikurse për familjen, për burrin, për fëmijën. Fjalë të mira dhe respekt për të gjithë na kanë bë.

PY. Vajzat e tuaja a e kanë vazhduar shkollën pas luftës?

PË. Jo. Nuk kanë mujt të vazhdojnë shkollën për shkak sigurie, se na tani ishim si të përcjellur. Jo kanë paraqit rastin për ngjarjen që ka ndodhë, i kanë paraqit rastin në

organet e drejtësisë të asaj kohe në EULEX. KFOR-i ka ardhë, të gjithë dhe s'kemi pasë siguri. Atë kohë kanë ndërpre vajzat shkollimin për shkaqe sigurie.

Se ndodhshin lloj-lloj raste të këqija, amorale. Dhe për këtë arsye na i kemi ndalu, ua kam ndërpre shkollimin vajzave.

PY. Dua të na ndihmoni që ta kuptojmë këtë punë pak më mirë. Si, në ç'mënyrë ndihesh më i pasigurt kur je viktimë e një krimi ose pjesëtar i një familjeje që ka qenë viktimë e një krimi, a mund të na e shpjegoni?

PË. Ndihemi të pasigurtë. Se ne nuk besonim se çka do të ndodhë çdo ditë. Edhe pse kishin bë krime, edhe pse kishin kry vepra penale ata, ne mendojshim, pritshim edhe ndonjë të keqe tjetër më të madhe dhe për këto shkaqe nuk ndiheshim të sigurtë. Vetëm prej disa personave, jo prej gjithë njerëzve apo dhe të ushtarëve të UÇK-së, por prej këtyre personave që kishin kry veprime kriminale dhe mund të kryjshin prapë në çdo ditë.

PY. Faleminderit. Më së fundmi, znj. Dëshmitare, na keni dhënë një fotografi tuajën dhe të burrit tuaj dhe të cilën donit që t'ia tregojmë Trupit Gjykues; a është kështu?

PË. Po.

Z. LAWS: [Përkthim] Ju lutem, që të vendosim materialin 7 që është në listën e materialeve tona. Dhe do ta nënvijëzoj që nuk duhet të transmetohet publikisht.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Vendoseni atë, të lutem, në ekran.

Z. LAWS: [Përkthim] Dhe ka numrin rendor që është V04030001.

PY. Çfarë tregohet në këtë fotografi që është në ekran, znj. Dëshmitare?

PË. Në këtë fotografi shifemi me burrin në foto kur kena qenë të fejuar. Në vitin 1973.

PY. Faleminderit, znj. Dëshmitare. Nuk kam pyetja të tjera.

PË. Faleminderit edhe prej jush.

Z. LAWS: [Përkthim] Do të kërkoj që kjo fotografi të pranohet si provë materiale.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem jepini një numër rendor kësaj prove.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të ketë numrin e provës materiale V1.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Faleminderit, Mbrojtësi i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, tani e ka radhën Mbrojtja për të bërë pyetjet e saj.

Avokati Mbrojtës, përpara se t'jua jap fjalën, Trupi Gjykues do të nxjerrë një urdhër gojor.

Kemi mbajtur shënim kërkesën e Mbrojtjes për të

shfrytëzuar gjatë me këtë dëshmitar dhe me Dëshmitarin 07 dhe 09 materialin me numër rendor DPS00065-DPS00068. Që është një email që na e keni dërguar më datën 27 mars në orën 18.43.

E kemi parë këtë material ditën e hënë, e kemi diskutuar gjerësisht gjatë marrjes në pyetjes të Dëshmitarit 08 dhe ne ju autorizojmë që ta shfrytëzoni këtë edhe për këtë dëshmitar edhe për dy dëshmitarët pasues.

Tani ju jap fjalën dhe keni parimisht të njëjtën kohë që ka pasur dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, që është pak më shumë apo më pak sesa dy orë.

Ju e keni fjalën.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Pyetje të palës tjetër nga z. Gilissen:
[Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, Znj. Dëshmitare.
PË. Mirëmëngjes, gjithashtu.
PY. Siç e dini, unë jam Avokati Mbrojtës i z. Shala. Por mos keni frikë.
PË. E kuptueshme.
PY. Faleminderit. Pyetjet që do bëjë nuk janë të synuara si kurth. Siç e ka shpjeguar Mbrojtësi i Viktimave, ne duam që të na ndihmoni që t’i kuptojmë të gjitha elementët e marra së bashku me qëllim që të mos bëjmë gabime. Dakord? Ky është synimi i pyetjeve të mia.

Pyetja --

PË. Në rregull.

PY. Dakord. Faleminderit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Pyetja ime e parë do të bëhet në publik, znj. Kryetare e Trupit Gjykues.

PY. Dje, ju na thatë që vetë z. Pjetër Shala i ka thënë burrit tuaj që ka ardhur tek shtëpia juaj në maj 1998. Pra, pyetja ime i referohet faqeve 83, 84 të transkriptit, rreshtat 17, 6 dhe faqet 84, rreshti 15 deri në 23.

Pyetja është shumë e thjeshtë: A mund të konfirmoni që z. Shala i kishte thënë burrit tuaj se kishte qenë tek shtëpia juaj në maj të vitit 1998?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, a mund të jeni më specifik lidhur me cilën vizitë.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Në maj të vitit 1998. Në *[REDAKTUAR]* maj. Vizitën të cilën e diskutuam për një kohë shumë të gjatë ditës së djeshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është e qartë kjo si pyetje për ju, znj. Dëshmitare

DËSHMITARJA: Po. Po. Mund të konfirmoj. Mund të jap përgjigje.

Se burri më ka thënë, më ka thënë se vetë Pjetër Shala në burgun arbitrar që e kanë ndalu në fabrikën e metalikut në Kukës, ka thënë "Mos e etiketo askëndin. Unë ta kam gjuajt *[REDAKTUAR]* Dhe unë kam ardhë me ta gjuajt edhe shtëpinë" në

vitin e përmendun. "Unë kam ardhë edhe te shtëpia me ta gjuajt shtëpinë". Vetë Pjetër Shala i ka thënë burrit kështu. Kështu më ka thënë burri dhe ka thënë kjo është e vërteta.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Faleminderit.

Z. GILISSEN: [Përkthim] I kërkoj Sekretares së Gjykatës që të vendosë në ekran materialin me numër 105370-TR-ET, Pjesa 1, e redaktuar, që është një variant i redaktuar i intervistës së -- e transkriptit të intervistës së ZPS-së e datës *[REDAKTUAR]*, e *[REDAKTUAR]* Pjesa 1, faqja 15, rreshti 16 deri në 19.

PY. A ju kujtohet, znj. Dëshmitare, që ju kanë marrë në intervistë ZPS-ja pak a shumë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] A mund avokati të na japë numrin rendor të variantit në shqip.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, a mund të konfirmoni cila faqe e variantit duhet ngarkuar në ekran.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po do t'jua jap këtë referim.

Ju kërkoj ndjesë për vonesën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'ka problem. Mjafton që t'i kemi në rregull dokumentet.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, znj. Kryegjykatëse. Kemi një problem nuk e di përse, po nuk po e

gjejmë lehtësisht.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka mundësi që të mos jetë në faqen 14 apo 15? Pasi kemi faqen 13 të variantit në anglisht.

Prokurore, keni fjalën.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Ndoshta mund ta ndihmojë unë Avokatin Mbrojtës me versionin në gjuhën shqipe.

Në qoftë se e kuptoj si duhet, në qoftë se është duke parë numrin 107350 [sipas përkthimit] rreshtat 16 deri në 19, në variantin në shqip kjo është në faqen 18, rreshtat 2 deri në 4, besoj.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, duket që është e saktë. Ju kërkoj ndjesë për këtë moment delikat.

Nëse më lejoni, znj. Kryegjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni, ju lutem.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Znj. Dëshmitare, ju thatë në këtë moment kur keni takuar hetuesit që:

"Kemi mësuar, kemi dëgjuar prej komshinjve se personi i cili kishte tromblonin, atë granatë-hedhësin, donin të gjuanin shtëpinë tonë dhe ai ka qenë Pjetër Shala që njihej edhe si Uki".

A të kujtohet t'ia kesh thënë këtë gjë ZPS-së?

PË. Po.
PY. Faleminderit. A mësove nga komshinjtë që Shala ishte personi që kishte granata-hedhësin?
PË. Burri i ka mësu këto. Por, nuk e ka përmend emrin nga kush. Nuk na ka thënë emër se kush i ka tregu.
PY. Faleminderit. Është shumë e qartë. Pra, ishte burri i cili i ka mësuar nga ato që bëhej fjalë për Pjetër Shalën i cili kishte pasur granatë-hedhësen në maj të vitit 1998. Kur e ka mësu këtë gjë burri juaj?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është 1998.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, 1998. Pyetja është kur e ka mësuar këtë gjë?
PË. E ka mësuar menjëherë pas kalimit të një kohe të kësaj ngjarjeje, mbase një javë, dy. Ka kërku që ta dijë kush ka qenë, meqenëse nuk e kemi njoh na të tjerët. Vetëm ata dy personat që kanë hyrë në oborr. Të tjerët nuk i kem njoftë.

Burrit i ka thënë një njeri, dy, i kanë thanë se ai ka qenë Pjetër Shala. Por emnin nuk e dimë kush i ka thënë.

Dhe këtë e ka vërtetue kur Pjetër Shala e ka pranu vetë në burgin në Kukës, në fabrikën e metalit në Kukës. Atëherë ma mirë e ka ndi edhe e ka ditë më saktë.
PY. Faleminderit. Shumë e qartë. Ajo që duam të kuptojmë është sesi është mësuar emri dhe nofka. Së pari a keni dëgjuar nofkën që, për shembull, Uki, Ujku e kështu me rashë apo emrin

Shala fillimisht?

PË. Si na ka transmetu burri, emrin dhe pastaj kanë thënë edhe nofka edhe kështu. Ata njerëz që i kanë thanë burrit. Burri na i ka tregu neve.

PY. Faleminderit. Na ndihmon shumë për ta kuptuar. Faleminderit.

Pyetja ime e dytë është si më poshtë. A e dini që burri juaj i ka dhënë deklaratë ZPS-së më *[REDAKTUAR]*

PË. Po. Më ka tregue se e ka dhënë intervistën, është intervistu nga Gjykata Ndërkombëtare. Ka qenë Gjykata që e ka tregu të gjitha intervistat, të gjitha ngjarjet i ka thanë aty.

PY. Faleminderit. Dua të përmend një deklaratë të burrit tuaj.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Dhe për këtë do i kërkoj Sekretarisë së Gjykatës që të na e nxjerrë në ekran. 082892-TR-ET-AT, Pjesa 1, redaktuar 3, Pjesa 1, RED3, faqja 36, rreshtat 15 deri në 17. Dhe do të përpiqem që të marrë dhe informacionin për shqipen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Propozoj që të vazhdoni dhe kur ta keni shqipen, na e jepni numrin dhe do ju luteshim që ditët e ardhshme përgatiteni paraprakisht këtë. Është mirë që t'i kemi të dyja tekstet në të dyja gjuhët.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit dhe për mirëkuptimin

tuaj. Sigurisht që në këtë formë duhet të veprojmë.

Mirë.

PY. Burri juaj tha:

"Gruaja ime më thotë se komandant Uki dhe djali i tij ishin përpara".

Pyetja ime është e thjeshtë. A i thatë ju burrit tuaj që ishte komandant Uki dhe djali i tij përpara shtëpisë tuaj apo përpara pronës suaj, pra, i thatë ju burrit që komandant Uki dhe djali ishin përpara pronës suaj?

PË. Jo. Unë burrit i kam thanë para pronës tonë dhe në oborrin tonë kanë hy për Hamëz Ibrahimi dhe Naser Ibrahimi. Që Hamzën e kemi njoftë, e Naser Ibrahimin nuk e kem njoftë. Vetëm atë ditë, ditën e parë e kam pa. Jo, nëse i ka thanë ndokush tjetër. S'po di.

PY. Faleminderit. E qartë. Po jua dha burri ju këtë informacion për komandat Ukin dhe djalin e tij, pra, jua tha ai ju?

PË. Po ai na e ka thënë. Kur kanë ndëgjue që e kanë tregue ata njerëzt ka thënë, se na ka spjegu dhe ne të familjes, ka thënë ka qenë komandat Pjetër Shala, ka qenë me tromblon që ka dashe me na gjuajt shtëpinë. Por ai e ka pranu edhe vetë në Durrës -- në Kukës. Ne na ka tregu burri që ka mësu nga njerëzit që i kanë thënë dhe na ka tregu familjes se ka qenë Pjetër Shala aty.

PY. Fakt. Faleminderit që ishit kaq e saktë. Po ishte

informacioni që mori që ai ishte me djalin?
PË. Cili?
PY. Burri juaj ju tha, ju tregoi që na thatë pak më përpara --
PË. Po, po.
PY. -- po a ju tha burri që ishte komandat Uki dhe djali, se këtu e kemi hallin tek djali, përmendet djali i tij. A jua tha burri këtë gjë?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem mund të hiqni një moment ndigjueset, znj. Dëshmitare?

Që të jemi të qartë, pyetja drejtuar znj. Dëshmitare, në qoftë se e kuptova unë të paktën, pra, ju i thoni: Burri a ju tha ju për praninë e djalit të komandat Ukit?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Të dy domethënë. Po djali. A ishte djali, ky është qëllimi i pyetjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra, ju doni të dini a ka qenë dhe djali i tij.

Atëherë, riformuloheni pyetjen: A ju tha burri që ishte dhe djali i komandant Ukit atje?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po janë të dyja pjesët. Dua të di, a ka qenë komandat Uki dhe djali i tij. Të dy personat, të paktën kështu e shoh unë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është mirë të bëni një pyetje. Nëse më lejoni, fillimisht trajtoni pjesën e komandantit, merrni përgjigje për atë. Dhe pastaj

pasi të mbaroni me pjesën e komandantit, mund t'i bëni pyetje dhe për djalin. Sepse mu krijua përshtypja se znj. Dëshmitare nuk e kuptoj.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Dhe unë të njëjtën përshtypje kam. Prandaj po jam shumë i kujdesshëm.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të vendosni ndëgjueset, ju lutem.

Z. GILISSEN: [Përkthim]

PY. Faleminderit. Faleminderit për kohën tuaj dhe po përpiqeni ato çka po ju shpjegojmë.

Unë dua të di nëse burri juaj ju tha ndonjë gjë për komandat Ukin.

PË. Na tha vetëm atë që personi me minahedhës krahu, me tromblon, ka qenë Ujku apo Pjetër Shala, që e kishte nofkën Ujku. Ashtu siç i kanë thënë ata personat që i kanë tregu se ka qenë aty Pjetër Shala, ai na tha dhe neve, na tregoi dhe ma tepër asgjë.

PY. Faleminderit. Tani pyetja që kam, pyetja tjetër është: Burri a ju tha ndonjë gjë për djalin e komandat Ukit, ua zuri në gojë djalin e komandant Ujkut?

PË. Jo. Neve jo.

PY. Faleminderit.

Në maj të 1998-s, e kishit dëgjuar ndonjëherë komandant Ujkun, Ukin apo ishte një pseudonim apo nofkë që s'e kishe dëgjuar ndonjëherë më përpara?

PË. Jo, ndonjëherë më përpara ne jo.
PY. Faleminderit. Faleminderit për ndihmën.
PË. Faleminderit, gjithashtu edhe prej jush.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Pyetja e tretë, po ashtu, mund të transmetohet publikisht.

PY. Znj. Dëshmitare, kur ju pyetën dje për kryesit që kishte identifikuar, që identifikoi bashkëshorti juaj si personat që e keqtrajtuan në Kukës, ju thatë, se ai ju tregoi, që prej tyre kishte qenë Pjetër Shala. Kjo u tha në transkript në faqen 88, rreshtat 9 dhe 10.

Megjithatë, kjo nuk është hera e parë që u përgjigjët për këtë pyetje apo jo?
PË. Po. Ashtu na tha. Ashtu na tha: Për torturat ka qenë prezent edhe që ka pranu se "Unë e kam ardhë e kam gjuajt *[REDAKTUAR]* edhe te shtëpia kam ardhë", pas një viti i ka ra, pas dy viteve me ardhë, 1998, në fshatin *[REDAKTUAR]* te shtëpia.
PY. Faleminderit. Ju ka intervistuar dhe Prokuroria.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe do i lutesha Sekretarisë së Gjykatës të vendosë në ekran ERN 105370-TR-ET-AT, Pjesa 2, transkripti i intervistës me ZPS-në.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem. Do ju lutesha që këtë informacion të mos ta ndanim në seancë publike.

Mjafton numri ERN.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëherë, Pjesa 2, data *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të më jepni arsyen pse do ta nxjerrim këtë dokument që ta miratojmë ose jo.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk doni në publik?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, do të doja të na tregoni paraprakisht për cilën arsye duhet ta vendosim në ekrane këtë dokument. Për çfarë arsye?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Dua t'i tregoj dëshmitares deklaratën që ka dhënë vetë, një pjesë të saj dhe pastaj do bëj pyetjen për të marrë informacion për ta verifikuar informacionin që ne të dalim në disa përfundime.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, vazhdoni.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Për Sekretaren e Gjykatës, Pjesa 2, faqja 9, rreshtat 12 me 18.

PY. Znj. Dëshmitare, ju bënë një pyetje ju dhe unë do ta lexoj pyetjen:

"Tani, përveç Sabit Gecit, Xhemshit Krasniqit dhe" një personi të tretë, nuk e di a mund ta them emrin me zë. Dua të jem i kujdesshëm. Është emri në ekran në qoftë se mund ta lexoni.

"... a mbani mend në qoftë se burri përmendi ndonjë nga këta personat si personat që e mbajtën të ndaluar atje në

Kukës dhe e keqtrajtuan? Ndonjë person tjetër përveç këtyre që janë këtu a përmendi burri juaj?"

Edhe ju jeni përgjigjur: --

PË. Po.

PY. – "Jo". Ju jeni përgjigjur "Jo"

Dhe përgjigja juaj ishte:

"Jo, nuk më tha gjë, nuk më tha ndonjë emër tjetër. Mbase kishte njerëz të tjerë atje, po ai nuk dalloi asnjë prej tyre".

Do doja të më thoni, të më konfirmoni këtë e keni thënë kështu apo jo?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, nëse po citoni, besojmë se duhet të citojmë ça ka thënë dëshmitarja po të gjithë rreshtat.

Jo. Unë sugjeroj -- unë ju pyeta pse po e nxirrni këtë pjesë të transkriptit, pikë së pari ju bëtë pyetjen nëse mund të na thotë kë mban mend, për kë i ka folur burri.

A mund t'i hiqni ndëgjueset, ju lutem, znj. Dëshmitare.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Rreshti 19-25, faqja 10, rreshti 1.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pyetja juaj ishte. Do të doja të dëgjoja nëse mund të na e konfirmoni këtë që keni thënë.

Por si e kuptova unë, nuk e ke thënë të plotë atë që ka thënë ajo, sepse është e qartë çka ka thënë më pas.

Po të shkojmë një hap përpara, të kalojmë një hap përpara, sepse transkripti është pikënisja jonë, pikënisja dhe pikëmbyllja jonë, sidomos sa u takon provave që do të përfshihen në dosjen gjyqësore, në dokumentacionin gjyqësor. Prandaj them bëni pyetjen dhe pastaj mbështetur në atë pyetje, mund t'i referohemi deklaratës së mëparshme.

Kjo është qasja. Sepse deklarata e mëparshme mund të paraqitet si pjesë e provave falë diskutimit që do të bëhet në gjyq. Po unë dua të di mendimin e -- dua të dëgjoj fillimisht ça ka për të thënë dëshmitarja.

Nëse ju na jepni vetëm tre rreshta dhe i kërkoni përgjigjen pastaj shkoni tek tjetra, e kuptoj që s'e keni për synim, po është çorientuese kjo. Prandaj nëse e lexojmë të gjithë, e bën pak më të qartë.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë e mendova që ishte më mirë ta ndaja me dy pjesë, po sigurisht që mund ta bëj në një moment të gjithë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta pyesim, fillimisht bëj pyetjen dhe pastaj i referohemi transkriptit. E kuptoj unë çfarë doni të nxirrni, po ka mënyra të ndryshme sesi mund ta pyesim, pse nuk ka thënë një emër të katërt. E kuptoj çfarë doni të pyesni.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëherë, mund t'i tregojmë dëshmitares, të vendosim në ekran të njëjtin dokument, faqja 9, rreshti 19 deri në 25 dhe faqja 10, rreshti 1.

Dhe unë do ta lexoj për të qenë i plotë, do të jap edhe shqipes, mbase është më mirë, faqja 10, rreshtat 22 dhe faqja 11, rreshti 5.

PY. Dhe po e lexojmë për dëshmitaren këtë:

"A e mbani mend, znj. Dëshmitare – e kanë pyetur - a të ka tregu burri përveç këtyre tre personave që erdhën në maj 1998?"

Ti thua: "Po".

Pastaj hetuesi të pyet: "Dhe ju keni përmendur emrin Pjetër Shala?"

Përgjigja është: "Po"

"Burri juaj a e përmendi ndonjëherë Pjetër Shalën lidhur me ato ngjarjen që i ndodhën në Kukës?"

Dhe përgjigja është: "Po. Po.

PË. Po.

PY. Po, ishte atje".

Pyetja ime është shumë e thjeshtë. Na është krijuar përshtypja se hetuesit ju pyetën ju -- jua dhanë këtë emrin. Dhe unë dua të më jepni mendimin tuaj, pra, ju si e mendoni këtë ose çfarë ndjesie keni ose çfarë mendoni ju për këtë.

PË. Unë e mendoj dhe e kam thënë atë çka më ka tregu burri, se është Pjetër Shala.

PY. Dua të jem i qartë, vetëm për të qenë i qartë. A e keni pasur apo jo ndjesinë -- a mos jua afroi ju hetuesi këtë emër se ju nuk e mbanit mend, mos jua vendosi ai këto fjalë si të

themi në gojë emrin e tij, mos jua serviri ai emrin e tij?
PË. Jo. Vetëm burri. Burri çka më ka thënë, unë e kam paraqit në intervistë.
PY. Faleminderit. Shumë qartë. Faleminderit. Okei.
Tani dua t'ju pyes për një hetues ose një gazetar. A ju kujtohet ju një gazetar apo një hetues me emrin Mike, ose Michael dhe mbani mend të jetë takuar ky Michael me burrin tuaj?
PË. Po. Po, ka dhënë intervista. Ndoshta ka qenë Gjykata e EULEX-it. Gjithsesi ndërkombëtare. Më ka tregu se ai ka qenë me emrin Michael një intervistues. E përmendte. Dhe asgjë tjetër.
PY. Ky Mike, a Michael, z. Michael mos ishte Michael Montgomery? Dini gjë dhe për mbiemrin e tij?
PË. Jo. Unë jo. Vetëm Michael.
PY. A e dini nëse ky person foli vetëm me burrin tuaj apo dhe me pjesëtarë të familjes foli ky?
PË. Jo. Vetëm me burrin. Vetëm me burrin ka dhënë në atë kohë intervistë.
PY. Faleminderit. Shumë e qartë.
Për mendimin tuaj, në qoftë se e dini, sa herë u takua ky Michael me burrin tuaj?
PË. Sa herë që e kanë ftu në intervistë. Vetëm në intervista është taku me Michael. Kur e kanë ftu në intervistë i kanë çu ftesën dhe ka shku ka intervistu. Hera të tjera unë nuk e di.

Vetëm gjatë intervistës që ka dhënë.
PY. A dini është takuar disa herë apo vetëm njëherë, pra, ka ndodhë disa herë apo vetëm njëherë?
PË. Për intervistë, s'e di një herë, dy e kanë ftu. S'muj me ditë ma tepër.
PY. Faleminderit. A e dini në qoftë se burri i dha ndonjë dokument a ndonjë farë shënimi këtij?
PË. Jo, nuk e di unë. Vetëm burri e din, e ka ditë. E ka transmetu krejt çka ka dhënë çka ka...
PY. Faleminderit. Burri a jua ka përmendur ndonjëherë vetë ju apo pjesëtarëve të familjes, u ka zënë ndonjëherë në gojë atë një shtëpi të verdhë, shtëpia e verdhë në Shqipëri, jua ka përmendur ndonjëherë burri?
PË. Kurrë. Asnjëherë. As mu, as pjesëtarëve të tjerë të familjes.
PY. Faleminderit. Shumë e qartë. Po ashtu a e dini në qoftë se burri -- jua ka përmendur ndonjëherë burri ju apo të tjerëve një Mercedes të verdhë, jua ka zënë ndonjëherë në gojë?
PË. Jo.
PY. Faleminderit. Shumë e qartë. Po ashtu ka përmendur ndonjëherë burri juaj ndonjë gjë për trafikim organesh, dini gjë?
PË. Kurrë. Asnjëherë.
PY. Faleminderit. Shumë e qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'ia fjalën Prokurores.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Nuk po e kuptojmë ku do të dali me këto pyetje Avokati. Sepse nuk duken relevante këto në raport me ato që u pyetën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë ju lashë liri veprimi sepse keni pjesën e kundërpyetjeve dhe nuk desha t'ju ndaloja. Po edhe mua më lindi pikëpyetja, ku po dilni ju me këtë.

A mund të na e shpjegoni tani cili është qëllimi i pyetjes suaj?

Ti kërkoj të heqin dëgjueses dëshmitares?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbase më mirë t'i heqë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem hiqni ndëgjueset, znj. Dëshmitare.

Avokat, ju lutem.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Po flisja për këto sepse ekziston një deklaratë, pra, ka një deklaratë të burrit të dëshmitares ku flet gjatë deklaratës që ka *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Mund të jap dhe rreshtat dhe informacionin. Nuk e di a është e nevojshme, por mund t'jua jap informacionin sepse e kam gati.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Na jep një përmbledhje se nuk po kuptoj ku do dilni.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Siç e dimë ky Tribunal është

themeluar bazuar mbi akuzën e trafikimit të organeve.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo është pikëpamja juaj.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Dhe ky dëshmitar ka qenë pjesë d një procesi lidhur me këtë. Dhe është interesante të shohim se nuk ka qenë dëshmitar vetëm në këtë çështje gjyqësore por edhe lidhur me akuzën e trafikimit të organeve. Ka dhënë informacione këtij z. Montgomery lidhur me këtë. Prandaj duhet të dalim në një përfundim dhe të paraqesim argumentet tona për të kuptuar pse duam t'ia shtrojmë këtë pyetje bashkëshortes së këtij dëshmitari.

Unë mund ta argumentoj që tani, po nuk e di a është momenti. Por në qoftë se është e nevojshme jam gati ta argumentoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prokuroria po ashtu është në këmbë. Po afron dhe ora 11.

Z. Prokurore, do ju jap ju fjalën.

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Do i lutesha Avokatit që të na japi referencën që ta gjejmë dhe ne dokumentin për të cilin po flet nga viti 2018, kjo është për qëllimin tonë. Ju lutem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju ishit gati ta jepnit referencën. Ju lutem jepni vetëm ERN.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Dhe dua të them që nuk kam pyetje të tjera, pse përgjigjet i mora. Përgjigjet janë shumë të qarta. Ajo s'ka asnjë dijeni për këtë. Kështu që unë s'kam

dokumente.

Dokumenti është ERN 082892-TR-ET-AT. Besoj kaq mjafton. Mund të jap dhe më shumë, por sikurse na udhëzuat unë po jap vetëm kaq.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sidoqoftë unë doja më shumë sqarime. Mbase numrin e faqes.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faqja 3, Pjesa 3, faqja 17 deri në 18, rreshtat 5 deri në 13.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Dua ta diskutoj këtë më tej, ta shtjellojmë këtë po në seancë private.

Por meqë erdhi ora 11.00, unë do falënderoj znj. Dëshmitare, për momentin, sepse tani po e mbyllim.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Në fakt, unë kaq pyetje kisha. Doja t'ju informoja dhe doja --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, ju kërkoj falje.

A na dëgjoni, Znj. Dëshmitare?

DËSHMITARI: Po. Mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokati sapo na informoi ne, si Trup Gjykues dhe Prokurorët dhe Mbrojtësin e Viktimave, se ai nuk ka pyetje për ju. Nuk ka asnjë pyetje shtesë për momentin.

Kjo përkon edhe me pushimin. Pas pushimit, do kemi mbase

dhe disa pyetje të tjera. Po tani do bëjmë gjysëm ore pushim dhe do takohemi pas gjysëm ore bashkë.

DËSHMITARI: E kuptueshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Mund të dilni, do ju ndihmojë Asistentja e gjykatës.

DËSHMITARI: Faleminderit, gjithashtu.

[Dëshmitarja përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Sekretare e Gjykatës, shkurtimisht a mund të kalojmë në seancë private, në qoftë se pranojnë përkthyesit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi kaluar në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare e Gjykatës.

Është ora 11.00. Do marrim një pushim prej gjysëm ore. Do të ritakohemi në orën 11.30 për të rifilluar menjëherë.

--- Pauza fillon në orën 11.03

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se vini edhe njëherë.

Të shohim a jemi të njëjtët persona këtu.

Shoh që është i njëjti edhe për Mbrojtësin e Viktimave.

Edhe në të majtë, po, shoh që pohojnë me kokë pala mbrojtëse.

Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem të na sillni në sallë dëshmitarin dhe një herë.

Dhe sa për ta shënuar në procesverbal faktin, që z. Shala po na ndjek me videolidhje.

[Dëshmitarja vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se vini.

Znj. Dëshmitare, tani do t'i japim palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave mundësinë për të bërë pyetje në një raund të dytë, nëse dëshirojnë t'u bëjnë pyetje.

Dhe po e filloj me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. A dëshironi që të bëni pyetje shtesë, Znj. Prokurore?

ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse nuk ka nevojë për pyetje shtesë nga ana e ZPS-së.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtësi i Viktimave, a dëshironi të bëni tjera?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pala

Mbrojtëse, a dëshironi të bëni ndonjë pyetje tjetër?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, palët dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk kanë pyetje të tjera për juve por kemi disa pyetje ne, si Trup Gjykues. Kështu që do t'ua jap fjalën gjykatësve për të bërë disa pyetje të tjera për të sqaruar --

DËSHMITARJA: Është e kuptueshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- disa çështje lidhur me deklaratat që na keni dhënë gjatë ditës së djeshme dhe të sotme.

Nuk e dëgjova përkthimin.

Dakord.

I hedh sytë nga e majta. Gjykatësi Bitti, ju e keni fjalën.

Pyetje nga Trupi Gjykues:

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, unë kam disa pyetje për t'ju bërë, për të sqaruar disa nga gjërat që thatë gjatë ditës së djeshme.

Dje, në faqen 82 të transkriptit, rreshtat 21 dhe 22, po flisnit për fabrikën e metalit në Kukës dhe thatë si më poshtë.

"... ishte një vend ku janë mbajtur edhe shumë të burgosur të tjerë".

Dje na dhatë disa nga emrat e këtyre të ndaluarve. Nuk ka nevojë që t'i përsërisni këta emra. Jam i interesuar për

fjalët që përdorët, ju thatë që "ishin edhe shumë të burgosur të tjerë".

Nga kush apo nga ku e ke marrë këtë informacion?

PË. Nga burri. Burri më ka tregu se ka pasë edhe shumë të burgosur të tjerë.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. A mund të shpjegoni më në hollësi se çfarë nënkuptonte ai kur thoshte "shumë të burgosur të tjerë"? A të ka dhënë ndonjë shifër tjetër? A ishin dhjetë, a ishin njëzet a ishin më shumë? A ka dhënë informacion më të saktë, më të posaçëm?

PË. Jo. Vetëm më ka thënë kështu se ishin dhe shumë të tjerë të burgosur. Numër të saktë nuk më ka thënë.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. A e kishte fjalën që njerëz nga ata të ndaluarit hynin dhe dilnin, pra, a kishte njerëz të cilët ishin të ndaluar për një periudhë të shkurtër, shumë të shkurtër kohe?

PË. Po. Kishte njerëz të ndaluar për kohë shumë të shkurtër, por kohë edhe më të gjatë. Thoshte edhe për nga një muaj kanë qëndrua aty. Për disa të burgosun e kish fjalën. Kush ishin ata, nuk më ka tregu.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit është me shumë dobi për ne.

Tani po kaloj në një temë tjetër.

Në faqen 84 --

PË. Nuk kam transkript këtu në ekran. S'ka nevojë ë?

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Unë e kam përpara syve. A keni problem këtu, znj. Sekretare, a ka problem për mosshfaqje të transkriptit?

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Seancës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja --

DËSHMITARJA: S'ka problem. Unë e kuptoj pyetjen edhe përgjigjena.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, do t'i kërkoj Asistentes së Gjykatës që t'i hedhë një sy transkriptit.

Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem hidhini një sy ekranit të dëshmitares për të parë, nëse mos është ngrirë ekrani. Është ngrirë?

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Seancës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, a e shikoni transkriptin tani në ekran?

DËSHMITARJA: Ende jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky është transkripti i seancës së sotme --

DËSHMITARJA: Vetëm në gjuhën angleze.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- siç po flasim tani.

Ne do të përkthejmë atë që thuhet në gjuhën shqipe me qëllim që t'i jepni përgjigje pyetjeve të kolegut tim.

Është e qartë?

DËSHMITARJA: E qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju e keni fjalën.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Dje në faqen 83 dhe 84 të transkriptit, ju thatë që burri juaj ishte torturuar në Kukës në faqen 84, rreshtin 5 dhe 6, përmendët personat të cilët e kanë bërë një gjë të tillë. Dhe thatë si më poshtë:

"Këta persona ishin Sabit Geci, Xhemshit Krasniqi. Ka patur edhe të tjerë, mes tyre Pjetër Shala".

A ka ndonjë arsye se përse i keni vendosur emrat në rendin që i keni vendosur?

PË. Jo, vetëm për të tregue se cillët persona e kanë torturue.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

A të ka përmendur burri ndonjë gjë lidhur me rolin e z. Shala, sidomos rolin e tij krahasuar me dy personat e tjerë që ke përmendur?

PË. Po. Ka tregu edhe për z. Shala. Se gjatë torturimit m'i ka paraqit edhe këto, ka thënë "Se mos e etiketo asnjë njeri. Se unë ta kam gjujtë *[REDAKTUAR]* në Rakovin. Por unë kam ardhë edhe te shtëpi me tromblon me ta gjujtë edhe shpinë ku ishit

tuj banue”.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Po përpiqem ta riformuloj paksa pyetjen time.

Kur ka përmendur njerëzit, që siç tha burri juaj, po e torturonin atë në fabrikën e metalit në Kukës, burri a të ka thënë lidhur me rolin e posaçëm të këtij personi? Për sa i përket kontrollit apo autoritetit, ndonjëri prej këtyre tre personave që keni përmendur, a ishte ndonjëri epror ndaj të tjerëve apo me sa ka kuptuar ai të gjithë ishin në të njëjtin nivel autoriteti, eprorësie?

PË. Sa ka kuptue, vetëm i ka njoft, i ka dit si persona, për autoritete, për pozitat e tyre nuk ka ditë asgjë. Nuk është njoftu. Vetëm i ka njoft si persona. Çfarë pozite kanë pasë nuk është njoftue. Kështu na ka tregu burri.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Përgjigja është tejet e saktë.

Kam një pyetje të fundit dhe bëhet fjalë për faqen 92 të transkriptit të ditës së djeshme, rreshtat 7 dhe 8, kur ju pyetën lidhur me pasojat që ka pësuar familja si rezultat i asaj që ka përjetuar burri juaj.

Dhe ju thatë që: “Ndikoi edhe nga pikëpamja ekonomike”.

A mund të shpjegosh se çfarë nënkuptuat me “kushtet ekonomike”?

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Gjithashtu kemi pasë humbje në ekonomi për gjendjen shëndetësore të bashkëshortit, për arsye se punonte edhe jashtë detyre kur u kthente te shtëpia. Mund të punonte diçka baçën, me mbjellë misër, me u angazhu pak edhe nga bujqësia. Por pas këtyre torturave s'ka mujt as një vit me punu më dhe me përfitue diçka për familje, për jetesën, për shpenzimet familjare. Për të gjitha këto na ka dëmtue.

Pastaj u nevojitën edhe shpenzimet shumë të mëdha për trajtimet mjekësore, vizitat, operacionet, sikurse në Kosovë në spitalin Amerikan, ashtu edhe në *[REDAKTUAR]* djali, që i ka shpenzu, i ka pagu. Kur kemi shku tre muaj, ia ka pagu edhe sigurimin pas kësaj. Edhe në *[REDAKTUAR]* ka pasë operacionet, operacione *[REDAKTUAR]* dy herë *[REDAKTUAR]* Pastaj edhe për vizitat *[REDAKTUAR]* spitalet *[REDAKTUAR]*

Ma vonë e ka kry operacionin në Kosovë, në spitalin Amerikan me vlera shumë të shtrenjta. Që na kanë ndihmue për fillim djali i dytë, *[REDAKTUAR]* e ma vonë kur janë punësu edhe djemtë tjerë. Nuk kam kemi pasë tjetër ndihmë nga askush përveçse djemve të mi. Shpenzimet kanë qenë mjaft të larta,

mjaft.

Me e llogaritë imtësisht kanë shku deri në 150.000 euro vetëm trajtimet mjekësore, operacionet, vizitat, këto medikamentet. Të gjitha që kanë kushtue. Pa llogaritur udhëtimet e tjerat shpenzime. Pa llogarit. Kanë qenë shumë të rënda.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit për përgjigjen e saktë.

Për sa u përket fëmijëve. Thatë që vajzat nuk ishin në gjendje që të vazhdonin shkollën. Po për fëmijët e tjerë a ka pasur pasoja për ta ajo që i ka ndodhur burrit tuaj; për shembull, kur bëhet fjalë për punësimin e tyre apo ndonjë pasojë tjetër?

PË. Jo, pasojat e tjera nuk kanë qenë, por djali *[REDAKTUAR]* i ka tërhek të gjithë vëllazërve, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* në firmën e tij. Dhe kështu që prapë na kanë ndihmu edhe ata neve.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Sot në mëngjes ju na thatë që vajzat nuk ishin në gjendje që të vazhdonin shkollën. Në faqen 15, rreshtat 24 dhe 25. Dhe nga dita e djeshme, unë mësova se *[REDAKTUAR]* Po ti, personalisht, çfarë pasoja ke pasur, ke pasur ndonjë pasojë?

PË. Asnjë pasojë. *[REDAKTUAR]* Shumë e respektume *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* gjithë populli i fshatit aty. Të gjithë qytetarët më ka bë respektin më të lartë që ekziston.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po a ishte e vështirë *[REDAKTUAR]* që vajzat e tuaja nuk ishte në gjendje të vazhdonin arsimin, shkollën?

PË. Ishte e vështirë. Ishte e vështirë. Po patjetër që të mos të ndodhë diçka edhe më e keqe u duhte të pajtohemi me i ndalue në shtëpi, me e marr me disa punë tjera, biznese punëdoreje, me punu pak te shtëpia dhe kështu.

GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Ju falënderoj shumë znj. Dëshmitare. Unë i përfundova pyetjet e mia. Faleminderit për përgjigjet që na dhatë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

DËSHMITARJA: Faleminderit edhe prej jush.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani ia jap fjalën z. Mikula për të bërë disa pyetje të tjera.

GJYKATËSI MIKULA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Kryetare. Kam dy pyetje për të bërë. A të ka treguar në mënyrë të posaçme apo në mënyrë të veçantë burri se cilat nga plagët që ka pësuar, i kishte si rezultat i asaj që i ka bërë z. Shala?

PË. Nga plagët nuk ka mujt me dallu, kush, cili nga këta persona i kanë ra në duar, këmbë, gjoks në ato momente. Nuk ka mujt me dallue, por ka thënë se edhe ai e ka torturue. I ka me ramje të forta diçka, objekte të forta, shufra hekri, gome e të tjera.

GJYKATËSI MIKULA: [Përkthim] A ka marrë pension burri pas luftës?

PË. Po. Ka marrë, por pension invalidor. Ka kalu prej pensionit bazë me 110 euro, ka kalu në pensionin invalidor i verbër. Si dhe i verbër dhe ka marrë 250 euro në muaj.

GJYKATËSI MIKULA:[Përkthim] Ky pension i është dhënë menjëherë pas luftës?

PË. Ma vonë pak dy-tre muaj -- dy-tre vjet qashtu. Ka shkue vetëm me pensionin bazë. Po. Dy vite mbas luftës. E ky invalidor ma vonë, kur ka fitu -- kur diabeti ia ka humb të pamurin, si i verbër i ka taku pension invalidor.

GJYKATËSI MIKULA:[Përkthim] Faleminderit, znj. Dëshmitare.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Dëshmitare

DËSHMITARJA: Faleminderit edhe prej jush.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi arritur fundin e dëshmisë suaj dhe dua t'ju falënderoj për përpjekjen që keni bërë në dhënien e kësaj dëshmie, unë besoj se do të na ndihmojë në përpjekjen tonë për të gjetur të vërtetën. Ju falënderojë për këtë arsye.

Dhe më duhet t'ju rikujtoj se nuk duhet ta diskutoni dëshminë e dëshmisë këtu me askënd, pra, dëshminë që keni dhënë para Dhomat e Specializuara nuk duhet ta diskutoni me askënd. A e kuptoni?

DËSHMITARJA: E kuptueshme. Dhe unë du t'ju falënderoj juve, znj Kryetare e Gjykatës dhe të gjithë stafin e juj dhe të gjithë të pranishmit këtu në sallë. Një falënderim për gjatë procesit të këtij gjykimi, për sjelljet e juja dhe pyetjet që keni bërë. Ju faleminderit të gjithëve.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Dëshmitare. Ju uroj një udhëtim të mirë të kthimit në shtëpi. Dhe tani po i kërkoj Asistentes së Gjykatës që t'ju shoqërojë jashtë sallës së gjyqit.

DËSHMITARI: Faleminderit. Faleminderit. Ditën e mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe ju ditën e mirë.

[Dëshmitarja largohet]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Asistente e Gjykatës.

Po i hedh sytë orës, kemi kohë të mjaftueshme për të vazhduar me dëshmitarin tjetër. Do të vazhdojmë me Dëshmitarin e Zyrës së Prokurorisë Prokurorit të Specializuar Dëshmitarit numër 07.

Përpara se të thërrasim dëshmitarin në sallën e gjyqit. A ka ndonjë çështje tjetër që duhet të zgjidhim?

E shoh që është ngritur në këmbë Prokurori.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, një çështje sa për të vërtetuar që çdo gjë ecën si duhet. Ndoshta a mos duhet ta pyesim z. Shala që po e dëgjon të gjithë

procesin në gjuhën që e kupton, me qëllim që të shohim nëse punon videolidhja dhe të mos kemi probleme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, a më dëgjon?

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Seancës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për shkak se unë nuk po ju dëgjoj juve.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] A më falni. Mikrofoni paska qenë i ndalun.

Po. Ju ndëgjoj fort mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dakord, z. Shala. Dhe unë po ju dëgjoj tani. Pra, konfirmohet lidhja. Dhe e shoh edhe që po dëgjonin edhe përkthimin.

A keni qenë në gjendje që ta dëgjoni të tërë seancën e ditës së sotme?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Unë po, po publiku jo, se është shumë e redaktume. E tërë pyetjet e avokatit tim kanë qenë të ndaluna. Edhe unë nuk e di si ka me më mbrojt mu Avokati kur nuk ndëgjohet. Ju faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala. Tani kemi verifikuar që jeni në gjendje ta ndiqni seancën dhe i kemi mbajtur shënim edhe ato që sapo i keni thënë Trupit Gjykues.

Dakord. Tani mund të vazhdojmë me dëshmitarin tjetër.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Seancës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për të bërë një test teknik duhet të kalojmë në seancë private për t'u siguruar që funksionon gjithçka siç duhet për dëshmitarin e radhës dhe pastaj do të kalojmë përsëri në seancë publike që të fillojmë me dëshmitarin e radhës.

Sekretarja e Gjykatës, na kaloni në seancë private, ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Asistente e Gjykatës, a mund të sillni dëshmitarin, ju lutem.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët, z. Dëshmitar. Vendosni ndëgjuesit ju lutem.

Z. Dëshmitar, mirëdita – sepse sa kaloi ora 12 – mirë se erdhët para Dhomave të Specializuara. A më dëgjoni?

DËSHMITARI: Po. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si jeni?

DËSHMITARI: Mirë, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar. Sot do fillojmë me dëshminë tuaj, por para se ta bëjmë këtë, unë do t'ju jap disa këshilla.

Në fillim do ju shpjegojë masa mbrojtëse që janë miratuar për dëshminë tuaj. E para është fakti që ju është caktuar një pseudonim, që do të thotë ne do të drejtohemi me fjalën "Z. Dëshmitar", nuk do të përdorë emrin tuaj. Do të sigurohemi që publiku të mos e marrë e vesh identitetin tuaj.

Gjithashtu është ndryshuar zëri dhe fytyra juaj, që do të thotë që askush jashtë kësaj salle gjyqi që po e përcjellë seancën nuk mund ta shohë fytyrën tuaj apo ta kuptojë zërin tuaj gjatë kohës që do jepni dëshminë.

Kur t'u përgjigjeni pyetjeve që nuk duhet të japim identitetin tuaj, do ta bëjmë në seancë të hapur, që do të thotë edhe publiku ta përcjellë çka po thuhet në sallën e gjyqit.

Kur t'ju kërkojmë të përshkruani ndonjë gjë që lidhet specifikisht me ju si person apo kur duhet të thoni fakte që mund të zbulojnë identitetin tuaj, ne do të kalojmë në seancë

private, që do të thotë nuk do të përcillet jashtë sallës së gjyqit dhe askush jashtë kësaj salle nuk mund ta dëgjojë çka po thuhet në këtë sallë.

Nëse thuhet ndonjë gjë këtu gjatë seancës së hapur që mund të zbulojë identitetin tuaj, ne do ta mbrojmë atë informacion. Transmetimi del me vonesë, prandaj para se të përcillet seanca, ne do të kujdesemi që ky informacion të hiqet nga transmetimi edhe nga transkripti publik.

A i kuptoni këto? I kuptoni të gjitha këto?

DËSHMITARI: Po. Po, faleminderit. Të gjitha.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, jeni thirrur të jepni dëshmi në çështjen Prokuroria kundër z. Pjetër Shala ta ndihmoni këtë Trup Gjykues të dalë me një vendim. Pasi të bëni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën, do ju drejtojnë pyetje përfaqësuesit e Prokurorisë, që janë me ato veshjet me ngjyrë vjollcë; pastaj do ju drejtojnë pyetje përfaqësuesit e mbrojtësve të viktimave, që janë në të majtën tuaj, pranë jush. Më pas avokatët mbrojtës të z. Shala, që janë në të djathtën tuaj me toga të kuqe. Dhe, në fund, do ju drejtojmë pyetje ne, gjykatësit e Trupit Gjykues.

Do të japim po ashtu disa këshilla për pyetjet që ne do ju drejtojmë.

E para, dëgjoni me kujdes çdo pyetje. Nëse nuk kemi kuptuar siç duhet pyetjen, lirisht kërkoni që pyetja të

përsëritet. Ne duam të na thoni të vërtetën, duam të na tregoni çfarë keni dëgjuar, çfarë keni parë, çfarë keni ndjerë, çfarë keni përjetuar. Nëse nuk e kemi parë vetë apo nuk e keni dëgjuar diçka vetë, tregoni këtu palëve si e keni marrë vesh këtë informacion.

Mbase nuk do ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve që kanë ndodhur dhe kjo është krejt normale. Dëshmoni mbi ato çka mbani mend. Nëse nuk e dini, thoni që s'ju kujtohet apo që nuk e dini diçka.

Përgjigjuni pyetjes. Dhe nëse kërkohet më shumë sqarim do ju kërkojmë ne këtë sqarim.

Është i qartë shpjegimi?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ashtu disa këshilla praktike.

Çdo gjë që themi këtu përkthehet - kemi përkthyes këtu – edhe regjistrohet, prandaj është e rëndësishme të flisni afër mikrofonit. Mikrofonin e keni -- keni dy mikrofona përpara. Funksionojnë shumë mirë. Ju lutem flisni qartë. Ju lutem flisni avash. Se kjo i jep mundësi përkthyesve ta bëjnë punën ta bëjnë punën siç duhet.

Duhet ta ktheni përgjigjen vetëm pasi personi që ua ka

bërë pyetjen e ka përfunduar këtë pyetje, përndryshe flasim të gjithë njëkohësisht dhe përkthyesit nuk marrin dot informacionin kur duhet. Kur t'ju drejtojnë një pyetje, prisni pesë sekonda përpara se të ktheni përgjigjen, sepse kjo na jep mundësi që ta ndjekim atë çka është thënë.

Shoh që po pohoni me kokë.

Nëse unë ngre dorën siç bëra tani, pushoni.

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ndonjëherë do ju kërkojmë të hiqni ndëgjueset apo kur kemi nevojë të diskutojmë diçka që mund të ketë ndikim në përmbajtjen e dëshmisë suaj.

Nëse ju keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim apo doni të thoni diçka, ngrini dorën që unë ta kuptoj se doni të thoni diçka dhe unë do jua jap fjalën.

I kuptuat të gjitha këto?

DËSHMITARI: Po. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Siç bëjmë me çdo dëshmitar tjetër, tani do t'ju kërkojmë të lexoni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Dhe ju kujtojmë se është vepre penale në juridiksionin e Dhomat e Specializuara që të jepni dëshmi të rreme.

Do i kërkojmë Asistentes së Gjykatës t'ju ndihmojë me tekstin. Dhe do ju lutemi të lexoni tekstin që keni përpara,

që është deklarata solemne.

DËSHMITARI: Faleminderit.

I ndërgjegjshëm e i ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: TW4-07

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani jeni nën betim për të thënë të vërtetën.

Dhe ne do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 07, me pyetjet nga Zyra e Prokurorisë së Specializuar.

Znj. Prokuror, fjala është për ju.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje nga Znj. Wyler: [Përkthim]

PY. Mirëdita.
PË. Mirëdita.
PY. Siç tha dhe znj. Kryegjykatëse dhe jua shpjegoi, që ju keni masa mbrojtëse që janë miratuar për të mbrojtur identitetin tuaj. Meqë unë do të bëj disa pyetje për të dhënat tuaja personale do i kërkoja Trupit Gjykues nëse mund të kalojmë shkurtimisht në seancë private që të flisni lirisht.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] ZPS-ja e ka parasysh parimin e seancave publike dhe besoj se e kemi demonstruar këtë dhe në

të kaluar kur kemi bërë pyetjet. Unë vetëm do ju kërkoja të kalonim në seancë private vetëm kur unë mendoj që pyetjet mund të nxjerrin informacion të mbrojtur dhe do të kalojmë në seancë private sapo që të jetë e mundur.

Po, për momentin, a mund të kalojmë në seancë private?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.

Znj. Sekretare e Gjykatës, na kaloni në seancë private ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

{Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore keni fjalën.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Atëherë dhe njëherë, çfarë pune bënte babai juaj në vitet 1990?

PË. Si polic u konë i Jugosllavisë në atë kohë, apo komander

qysh, si ta quani, i një terreni. Si oficer, apo gjysh e thërrasin këtu, policie.

PY. A ju ka treguar ndonjëherë babai pse zgjodhi që të bëhej oficer policie?

PË. Për këtë s'kam patë asnjëherë -- s'e kam pyet. Ai ka qenë qysh në rini kur a konë me këtë profesion; 23-24 vjeçar.

PY. Si e përshkruani babain tuaj, si mund ta përshkruani babain tuaj si person deri sa filloj lufta?

PË. Çdo kush thotë që e dun një baba, por unë e kam dashtë ashtu si a kanë. Me të gjitha të mirat, na ka shkolluar, na ka edukuar. Të gjitha çka i përket një fëmije, ato çka ka patë mundësi me e bë. Një babë shumë i lumtur a konë për mu.

PY. Edhe këtë pyetjen do ta bëjmë në publik. Por ju lutem mos përmendni emrin e vendit, a jetonit në Kosovë në vitin 1998?

PË. Po.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë private për pyetjet e tjera?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare e Gjykatës kalojmë në seancë private?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Prokuroria mund të vazhdojë me pyetjet.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.
PY. Z. Dëshmitar, ju na thatë që deri në pranverën ose verën e vitit 1998 jetuat e gjithë familja në një fshat në Kosovë dhe më pas u larguat nga ky fshati. Dhe kjo është thënë në transkript në faqen 58, rreshtat 24 dhe 25.
Po pse ikët nga ai fshati ku jetonit deri atëherë?
PË. Ne ikëm se kanë ardhë disa persona të veshur do -- ishin të veshur në tesha podohiju. Ashtu na rrethuan te shtëpia, ne i thojmë gardh, si i thoni këtu, gardh i thojmë një muri prej druni ashtu si e bëjmë. Atje ishin 13, 14 deri në 15 vetë të rrethum. Dy vetë kanë ardhë brenda në oborr. Dhe e lypshin babën edhe armët e tine.
Dulëm ne, unë, vëllai i madh, nana dhe vëllai i vogël dolëm në oborr për të biseduar me ta. Ne nuk i njifshim.
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
Ashtu kemi -- ka bisedu me ta edhe vëllau *[REDAKTUAR]* ashtu, si thojnë me fjalë, jo -- dojshin me hi mrend. Ne s'i lejshim. Babait ju kanë lut motrat që mos del.
Dhe vëllau vogël ka -- ja kanë marrë vëllaut të vogël një pistole dhe me atë pistole janë largu. Por para se me ndodhë ajo, se me i marrë pistolën, domethënë, një me një minahedhës

apo tromblon qysh i thojnë, a kanë nga gardhi atje dhe u ka thënë “Largoji ta gjuaj shtëpinë”. Ashtu ka ndodhë. Dhe ja ka bë me dorë që ndalu. Ja ka marrë armën vëllaut. Nna -- dhe e kanë lanë se jemi prej shtabit të Jabllanicës të dërguar këtu. Si komandant a konë Lahi Brahimaj.

Pastaj e kanë marrë armën dhe nëna ju ka thënë -- e kanë lënë, i kanë thënë nënës që duhet të vish atje. Ka thënë "Nesër vij me e marr burrin, djemtë e krejt e vijmë në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë. Po ne në mbrëmje e kemi lëshu atyhen dhe jemi shku në Gjakovë. Kemi gjetë banesë aty në Gjakovë dhe aty jemi strehu derisa kanë ik për Shqipëri. Kanë ik familja. Po unë jam kanë te *[REDAKTUAR]*.

PY. Ju lutem emrat ta keni parasysh. Emrat edhe të personave dhe të vendeve, ju lutem.

Do flasim pak më shumë për këtë incidentin e verës a pranverës së 1998-s përpara se të kaloj tek pyetjet e radhës që kanë të bëjnë me vitin e mëpasshëm.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem a mund të fusni në këtë pyetje, faqja 61, rreshti 3, ku dëshmitari ka thënë “ai mori armën nga vëllai”. Unë s’e kuptova për kë e kishte fjalën.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Më herët cekët që personat që erdhën në banesën tuaj, që ishin pjesërisht me uniforma, pjesërisht me rroba civile. A mund të na thoni çfarë uniformash kishin mbathur, mbanin?

PË. Këta dy çka kanë qenë në oborrin e shtëpisë, kanë patë uniformë dhe shenjën e UÇK-së. Armën që ja ka marrë vëllaut, ja ka marrë Naser Brahimaj. Dhe me atë armë janë largu nga shtëpia, që nana ju ka thënë që "Nesër në 10.00 jam atje, në Jabllanicë". Por ne s'kemi shku, atë natë jemi largu nga shtëpia dhe jemi shku për Gjakovë jemi strehu në qytetin Gjakovë.

PY. Përmende një armë, një minahedhëse, që ishte pak larg nga vendi ku ishe ti. Po armë të tjera a ke pa?

PË. Po. Këta që ishin në oborrin e shtëpisë kanë patë armë. Naseri, një ndër ta, e ka patë dhe një, si thojnë, snajper kështu me turbi. Ata tjerët që ishin te gardhi atje, të gjithë janë konë të pozicionum dhe me pozicion prej shtëpisë tanë me automatike, me Kallashnikov, me ça kanë pasë. Ashtu s'kam mujt edhe mi i ditë se kush janë. Janë kanë në uniformë, pa uniformë, me kapela, me maska. Por s'e kemi njoftë asnjë. Përpos nëna e ka njoftë Hamëz Brahimaj nga që a konë në oborr.

PY. Faleminderit. Thatë që vëllait ia morën armën. A mund të tregosh më hollësisht se kur ndodhi, për çfarë arme bëhet fjalë dhe e kujt ishte ajo armë?

PË. Armën ia kanë marrë vëllaut. Ata lypshin edhe armët tjera, çka i kanë taku babës zyrtarisht. Po një armë të vogël iu ka lut motrat dhe vëllai që ta jep dhe t'i vep, t'i largojmë nga aty. Ua ka dhënë atë armë vëllai i vogël dhe kanë thënë "Nesër në ora 10.00 me ardhë në Jabllanicë të gjithë".

Nëna i ka thënë që "Do vimi nesër ora 10.00 atje". Por ne s'e kemi pritë të nesërmen. Atë natë jemi largu prej aty në Gjakovë.
PY. Armën që ia morën vëllait, a ishte kjo armë e babës apo ishe armë që i takonte vëllait vetë?
PË. Ne kemi edhe armë që e kemi ruajt katundin. Po atë armë e ka marrë nga shtëpia dhe ajo armë a konë e babait.
PY. Përmende që nëna ka njohur njërin nga personat që kanë ardhë në oborrin tuaj dhe po kështu edhe personin tjetër. A e dini, a keni njohur apo keni dijeni për ndonjë ushtar tjetër, anëtar tjetër të UÇK-së që ka qenë i pranishëm atë ditë?
PË. Atë ditë ka njoftë vetëm Hamzën. Por Hamëz Ibrahimaj -- por Naser Ibrahimaj, s'e kemi njoftë. Pastaj i kemi marrë emrin dhe baba që e ka ditë se kush a kone aty mbas një kohe të gjatë.
PY. Po a keni mësuar emrin e ndonjë personi tjetër që ka qenë i pranishëm aty atë ditë?
PË. Po. Po mbas një kohe të gjatë. Mbasi u kthy babai nga Shqipëria.
PY. Çfarë keni mësuar nga babai apo çfarë ka mësuar babai në kohën kur është kthyer?
PË. Babai ka treguar si e kanë kidnapuar në Shqipëri. Si e kanë çuar në një fabrikë metali në Kukës, torturuar, rrahur dhe persona do i njeh e do nuk i njeh. Po aty e ka zbulu që në sulmin e shtëpisë ka qenë edhe Pjetër Shala. Po ka edhe emra

tjerë që e din për maltretimin, rrahjet dhe që ia kanë bë në Kukës. Si a si i përmendi edhe ata emra tash, nëse --
PY.  Do ta trajtojmë këtë çështje pak më vonë.
PË.  Okej.
PY.  Po le të rrimë paksa tek ky incidenti i vitit 1998.
     Thatë që më vonë babai mësoi që atë ditë në maj -- ju kërkoj ndjesë në pranverë të viti 1998 atje ka qenë edhe Pjetër Shala; kështu është?
PË.  Po.
PY.  Çfarë ekzaktësisht ka mësuar babai lidhur me praninë e Pjetër Shalën atje atë ditë?
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
dhe "Pse nuk dole ti kur të erdha te shtëpia?"
PY.  Dhe kur tha "Pse nuk dole kur erdha tek shtëpia?" për çfarë e kishte fjalën?
PË.  Kur janë kanë Hamëz dhe Naser Ibrahimaj në atë kohë kur na kanë sulmu te shtëpia, në 1998, në fshatin ku i kemi jetu.
PY.  Përveç familjes tënde a kanë pasur njerëz të tjerë ta kenë parë këtë që ka ndodhur në shtëpinë tuaj në verë apo pranverë të 1998?
PË.  Nuk e di. Mund të ketë qenë kojshija, po nuk e di kush.
     ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të

kalojmë në seancë private për të bërë një apo dy pyetje?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dakord.

Por përpara kësaj, t'i japim fjalën Avokatit të Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë edhe njëherë. Në transkript në faqen 62 --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më lejoni që të gjej faqen 62 me qëllim që ta ndjek atë që do të thoni.

Z. AOUINI: [Përkthim] Më kanë thanë disa nga anëtarët e familjes që është përmendur rroba që është thënë kapele e maska e kështu me radhë, të cilat nuk janë në transkript pavarësisht se i kam dëgjuar këto hollësi dhe ndoshta mund të sqarohet për sa i përket kjo çështje transkriptit, pra, për çështjen e transkriptit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë shoh në rreshtin 4 që: "Dy personat që kanë ardhur në oborr kishin uniformat e UÇK-së dhe emblemat e UÇK-së". Aty, në atë pjesë bëhet fjalë? Për atë pjesë bëhet fjalë?

Z. AOUINI: [Përkthim] Pak më poshtë, e nderuar Gjykatëse, aty ku përshkruhen rrobat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë mendoj që nuk ka nevojë që ta verifikojmë atë që është thënë në atë kohë, tani. Por, në qoftë se keni nevojë jepen hollësi

të mëtejshme, atëherë mund të bëjmë verifikimin nga seksioni i përkthimit, në qoftë se janë thënë fjalë të tjera atëherë mund t'ia shtojmë transkriptit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Kryegjykatëse, unë sugjeroj që mund të bëhej pyetja për ta sqaruar këtë çështje, pyetjet shtesë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë mund ta bëjmë, por është e rëndësishme të dëgjojmë edhe çfarë është thënë më poshtë.

Po ju thoni pak më poshtë?

Z. AOUINI: [Përkthim] Tek rreshti 17, 18. Kur bëhet fjalë për një grup ushtarësh. Aty ku janë përmendur kapele, maska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, ju e keni fjalën, unë kam vështirësi për të identifikuar rreshtat që po diskutohen.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Besoj se është faqja 62, rreshti 16. Po nuk është problem, unë mund të bëj pyetje shtesë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dakord. Vazhdoni.

Ju e keni fjalën dhe mund ta bëni këtë kur të mendoni që është momenti më i përshtatshëm.

Faleminderit, Avokat i Mbrojtjes.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Sa për sqarim, Dëshmitar. Kur përmende personat të cilët ishin brenda në oborrin tuaj apo rreth tij, në vitin 1998, fole diçka lidhur me rrobat që kishin veshur. Të lutem, a mund

ta përsëritësh?

PË. Po. Ata dy persona, Hamëz Ibrahimaj dhe Naser Ibrahimaj janë kanë nën uniformë dhe me emblemë UÇK. Ata që kanë qenë te gardhi, disa ishin me uniforma, por emblemën s'e kam pa që shënon diçka, se ishin diku jo 25 metra apo 30 metra, nuk jam i sigurtë. Po gardhi që, i thojmë na, ajo është në objektin tonë. Ajo pasuni e jona. Ata janë vu rresht aty, armët i kanë drejtu nga ne. Këta dy janë ardhë në oborr dhe kanë bisedu me ne. Ne jemi kanë normal të sulmum aty, të gjithë armët prej nga shtëpia jonë i kanë patë edhe minahedhësin, atë tromblonin që i thojshin. Ai a konë hazër për sulmin.

Ne me këta të dy çka janë konë në oborr me këta bisedu nëna, vëllau që u ka thënë nesër vijmë në Jabllanicë. Po mos t'u thojke ashtu bën vaki kishte të ndodhë edhe ma keq aty.

PY. Edhe njëherë tek rrobat, keni folur që disa kishin uniforma disa nuk kishin ose ishin pjesërisht me uniformë. A kanë pasur gjëra të tjera përveç uniformës? Çfarë tjetër kanë pasur veshur?

PË. Rroba civile, si i thojnë, normal rroba kështu si veshet i përdidshmi një njeri jo ushtarak apo polic. Disa janë kanë me uniforma, uniforma i thojmë ato teshat ushtarake apo policore. Disa s'janë kanë, civil. Po armë konë patë të gjithë. Se për të gjithë janë ardhë aty për me sulmu, se ajo është, si i thojnë, pronë e jona. Kur ta drejton dikush armën prej pronës tënde, gardhi është pronë e jona. Kur drejtohet

arma prej shtëpisë tënde, të vijnë në oborr, ajo normal është sulm.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, të lutem vetëm përgjigju pyetjes që të jepet, pasi aktualisht po flasim vetëm për rrobat. E di që dëshiron të na japësh informata të shumta ne, si Trupi Gjykues dhe Prokurorit të Specializuar, por përpiqu t'i përgjigjesh vetëm pyetjes me qëllim që të sigurojmë informacionin vetëm për pyetjen e bërë në mënyrë të posaçme.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar --

PË. Urdhëro.

PY. Po e bëj pyetjen në mënyrë pak më të posaçme. Këta personat e tjerë, a kanë pasur ndonjë gjë në kokë, maska, kapele, për shembull?

PË. Maska, kanë patë disa maska. Disa kanë patë kapele, disa tesha normale civile kështu si thojnë, disa kanë patë ushtarake. Maska i thojmë ne ku nuk shihet fytyra. Edhe armët të drejtuara nga ne.

PY. Faleminderit. E keni sqaruar.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të kalojmë tani në seancë private për të bërë një apo dy pyetje?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dakord.

Znj. Sekretare e Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë

private?

[Seancë private] [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F541*

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Znj. Prokurore, ju e keni fjalën.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, na thatë para kësaj që ikët nga *[REDAKTUAR]* në vitin 1998. Ku shkuat?

PË. Në Gjakovë.

PY. Nëse ku kam kuptuar si duhet, keni ik edhe nga Gjakova. Ku keni shku nga Gjakova?

*[REDAKTUAR]* U blloku rruga në atë kohën e luftës, i bllokojshin rrugët dhe kam mbetë atje. Familja jeme, s'i kam ndëgju, mbasandajna nga Gjakova kanë ik me popull që kanë shku në Shqipëri si refugjatë si i thojnë. Dhe deri pas lufte s'jemi taku më. Unë s'kam qenë në Shqipëri.

PY. A të kujtohet koha kur familja ka shkuar në Shqipëri?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, unë besoj që këtë pjesë mund ta bëjmë në seancë publike.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Përpara se të kalojmë në seancë publike.

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po mund të kalojmë në seancë publike edhe njëherë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, të kalojmë në seancë publike edhe njëherë. Faleminderit.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, na thatë që familja shkoi në Shqipëri në një pikë të caktuar dhe doja t'ju pyesja nëse të kujtohet data kur është larguar familja?

PË. Nuk e di.

PY. A të kujtohet nëse ka lidhje me ndonjë ngjarje, ju kujtohet muaji apo viti?

PË. Besoj se nga fillimi i vitit. Ashtu mendoj unë. Në fillim të vitit. Shkurt apo mars.

PY. Cilit vit?

PË. 1998. 1999. Më falni.

PY. A të kujtohet nëse kjo ka ndodhur përpara apo pas bombardimeve të NATO-s?

PË. Përpara.

PY. Pasi shkuan në Shqipëri pjesëtarët e familjes tënde, a të kujtohet ndonjë incident që ka të bëjë me babain?

PË. Mbasi janë kthy nga Shqipëria më ka tregu babai. Prezent s'jam kanë.

PY. Shkurtimisht, a mund të na shpjegosh tani pasi do të hyjmë më në hollësi, më në thellësi më vonë, për çfarë bëhet fjalë, për çfarë incidenti bëhet fjalë?

PË. Kur janë shku në Shqipëri, aty ku janë strehu në Durrës, që ka patë disa herë përcjellje. Disa herë. Ashtu si ka tregu, na kanë përcjellë, si do ta marrin babain apo si i thojnë kidnapim, ku banojnë, për ta marrë aq lehtë sa munden nga disa persona. Ndërsa një ndër ta e njoh edhe unë. Por edhe *[REDAKTUAR]*.

PY. Të lutem mos përmend emra. Po a mund të tregosh pak më në hollësi lidhur me këtë incident?

PË. Kam dëgju që e kanë arrestuar babën apo kidnapuar dhe e kanë çu në drejtim të Kukësit. Në një vend e kanë ndalë diku, nuk më kujtohet emni, për një natë apo dy nuk e di - s'jam i sigurtë - çka kam dëgju prej babës. Rrahur, maltratuar. Kam dëgjuar që i kanë thënë njëri-tjetrit se "Do ta vrasësh ti apo ti?". Ashtu si ka thanë babai. Pastaj e kanë mbajtur, kanë

shkuar në Kukës dhe atje e kanë mbajtur diku 13 ditë apo më shumë nuk e di saktë.

PY. Faleminderit. Thatë që babai të ka treguar dhe tregove edhe kohën kur ka ndodhur, por dua ta përsërisim edhe njëherë.

Kur ekzaktësisht të ka treguar babai për këtë incident?

PË. Mbasi u kthy nga Shqipëria, diku qershor.

PY. Qershor i cilit vit?

PË. 1999.

PY. Kush tjetër ka qenë i pranishëm kur të ka treguar babai lidhur me këtë incident?

PË. Të gjithë familja.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po i hedh një sy kohës dhe mbase do të ishte koha e përshtatshme për të marrë pushimin e drekës, nëse jeni dakord.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore. Isha edhe unë gati për t'ju pyetur, faleminderit që po vëreni që po arrijmë në orën 13.00.

Z. Dëshmitar, tani do të marrim një pushim për të ngrënë drekën, deri në orën 14.00, një orë pushim. Dhe pastaj do të vazhdojmë me pyetjet për juve.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Ndihmëse e Gjykatës, do t'ju shoqërojë jashtë sallës së gjyqit. Shpresoj që të kemi mundësinë të pushoni dhe të hani drekë.

DËSHMITARI: Faleminderit. Gjithashtu.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi pushim deri në orën 14.00.

Seanca mbyllet.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.57

--- Seanca rifillon në orën 14.00

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të gjithë më këmbë.

Uluni ju lutem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u kthyet. Po i hedh një sy të shpejtë ekipeve, të të gjitha palëve. Dhe mesa shoh jemi të njëjtat – në të njëjtën përbërje që ishim më herët.

Z. Shala a më dëgjoni? Ju shoh që pohoni me kokë. Po a mund ta hapni mikrofonin dhe të na e thoni me zë, ju lutem për procesverbalin.

I AKUZUARI: Po, ju dëgjoj fort mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

Do vazhdojmë me pyetjet e dëshmitarit të thirrur nga ZPS-ja, Dëshmitari 07. Nëse nuk ka ndonjë gjë që palët duan të parashtrojnë aktualisht me Trupin Gjykues, atëherë unë do të thërras dëshmitarin në sallën e gjyqit.

Asistentja e Gjykatës, a mund ta sillni dëshmitarin ju

lutem?

Shoh që kemi edhe publik në galeri, të keni parasysh këtë gjë dhe bëni kujdes.

[Dëshmitari fillon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u kthyet z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të vazhdojmë me pyetjet që do t'jua drejtojë Zyra e Prokurorit të Specializuar. Do t'ia jap fjalën Prokurores për të vazhduar me pyetjet.

Prokuroria, fjala është për ju.

ZNJ. WYLER: : [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

PY. Z. Dëshmitar, para pushimit ju na thatë se babai ju kishte thënë, dhe në transkript kjo ishte faqja 70, rreshti 25 deri në faqen 71, rreshti 3 – pra, babai ju kishte thënë që e ishin kidnapu e kishin çuar që Kukës. Atje e kishin mbajtur të ndaluar dhe e kishin keqtrajtuar.

Do të doja të dija çfarë ju tha babai për këtë incident, por hap pas hapi. Filloni na tregoni që në momentin e kidnapimit, mos harroni ju lutem mos thoni emra personash dhe emra vendesh. Do ju bëj unë pyetje sqaruese në qoftë se lind nevoja.

Pra, saktësisht, çfarë ju tregoi babai për kidnapimin e

tij?

PË. Babai thotë që kanë qenë katër persona. Ku e kanë kidnapuar dhe kanë shkuar në drejtim të Kukësit. Nji vend, por nuk jam i sigurt si ta quaj, Rrumbullak, a Trundullak, nuk e di. Aty e kanë mbajtur nji natë apo dy, s'jam i sigurt. Por mbajt e kanë aty. Dhe atëherë, me tre të burgosur të atyhit, e kanë çu në Kukës. Vetë i katërti është kanë.

Nji vend ku i kanë ndaluar, i kanë thënë që -- "A po e vret ti, apo unë" ata personat që e kanë kidnapu. Dhe babai ka thënë, "A ju njeh djali". "A të njeh djali", dikund. "Vramëni kur të doni". Ka vazhdu rruga dhe nuk e kanë bo atë gjest, s'e kanë vra domethënë. Atëherë e kanë çuar në Kukës. Aty e kanë shti në atë farë burgun ku thotë, pa krevat, pa kurrgjë, dysheme si i thojna, beton. S'ke ku të ulesh, s'ke ku të fjetësh, veç në beton. Pa asgjë aty. Ushqimet jo të mjaftueshme, ujë jo të mjaftueshëm. Keqtrajtime, rrahje, me pajsboll si i thojnë, shipka hekuri, në Kukës në fabrikën e metalit.

PY. E kuptoj që është e vështirë të flisni për këtë, z. Dëshmitar. Por, a ju kujtohet ndonjë hollësi tjetër mbase? Çfarë ju ka thënë babai për keqtrajtimin -- në Kukës?

PË. Keqtrajtim, i kanë rrahur, siç thotë babai, kanë hi edhe natën edhe ditën. I kanë rrahur të gjithë. Babain edhe të burgosurit aty. Atje ka patur edhe të tjerë të burgosur, jo veç babai im.

Ashtu thotë.

PY. Për sqarim, këto rrahjet, ndodhën vetëm një herë, apo ndodhën më shumë se një herë?

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Ju lutem, mbyllni mikrofonin pasi të mbaroni përkthimin.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju përsëris pyetjen.

PY. Edhe një herë, më falni. E rrahën një herë të vetme apo e rrahën më shumë se një herë, e rrahën disa herë?

PË. E kanë rrahur disa herë.

PY. A ju tha ndonjëherë babai kush ishte atje? Kush merrte pjesë në këtë maltrajtime?

PË. Po.

PY. A mund të na i thoni emrat?

PË. Po. Xhemshit Krasniqi, Pjetër Shala, Sabit Geci edhe të tjerë që nuk i ka tregu emrat. Nuk i dimë dhe s'-- thotë që s'i ka ditë.

PY. Gjatë kohës që e mbajtën të ndaluar në Kukës, a e morën ndonjëherë në pyetje babain?

PË. Thotë që po.

PY. A ju tha gjë çfarë pyetjesh i kishin bërë kur e kishin marrë në pyetje?

PË. Po i kanë bo pyetje si, si ke punuar ti me policinë jugosllave, serbe. I kanë thënë disa gjëra të tjera si, "Prano që i ke vra 100 vetë dhe ke dhunu". Babai ka thënë që, "Qitma t'i njoh ndër sy që i kam bo ato. Do t'i pranoj të tana". A

këto i kam ndi prej babait çka i kanë thanë. Atëherë, i ka thanë Pjetër Shala si -- "Pse e ke lyp ti kush ta ka gjujt *[REDAKTUAR]*? Atë e kam bo unë", edhe "Pse s'dole te shtëpia, kur erdha"?

PY. A i thanë -- ndonjëherë babai a akuzohej për ndonjë krim babai, cila qe arsyeja që e mbajtën të ndaluar në Kukës? A ia thanë ndonjëherë?

PË. Jo. Veç pse, si polic që është konë dhe si i thonë, spiun. Për detyrën e vet që e ka mbajtë, si polic, oficer apo komander policie.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private për pyetjen e radhës?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretarja e Gjykatës, të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F541*

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Prokuroria, mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Flas për transkriptin, faqja 74, rreshtat 15 dhe 17. Në këtë pjesë ju keni thënë "ata", "ata u rrahën", thoni ju. A ju ka treguar ndonjë gjë babai për persona të tjerë që mbaheshin të ndaluar atje apo që janë maltrajtu gjatë kohës që kanë qenë në Kukës?

PË. Të gjithë të burgosurit çka janë kanë aty janë rrahë. Si kanë patë dëshirë ata. Kanë hi, kanë rrah, i kanë lanë përtokë ashtu. Edhe të tjerë. Ndër ta ishte edhe Pjetër Shala, Sabit Geci dhe Xhemshit Krasniqi.

PY. A ju ka thënë ndonjëherë -- emrat e këtyre të burgosurve të tjerë babai, dhe mund t'i thoni emrat në qoftë se i dini sepse jemi në seancë private.

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit. Mund të kalojmë sërish në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretaria të kalojmë në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Prokuroria mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Ne biseduam për ato çka ju ka treguar babai pas lirimit. Por unë do doja t'ju pyesja tani disa pyetje për ato që ju vetë vutë -- çfarë vutë re, çfarë vrojtuat ju tek ai.

Babai, a kishte ndryshuar kur u kthye nga Kukësi në qershorin e vitit 1999?

PË. Unë s'kam qenë në Shqipëri kur u kthye. Por u kthyen në

Kosovë që u ardhë, e kam vërejt që babai ka patë rrahmje, në krye. Aty e kam hetu dhe e kam pyet nanën, ça ka baba në kokë. E ka patë nga rrahmja -- atëherë më ka tregu edhe babai vetë se ça i ka ndodhë atje.

PY. Çfarë shenjash patë tek ai, çfarë lëndimesh patë tek ai?

PË. E ka patë këtu para në ballë ku shifet, si thojnë, në krye këtu, e ka patë të dëmtuar, të shembur, si i thojnë. Nga rrahmja. Por unë s'e kam ditë që e kanë kidnapu babën, por kur janë ardhë në Kosovë e kanë -- më kanë tregu familja. Se unë s'kam qenë në Shqipëri.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për procesverbal ju lutem, kam nevojë të bëj një pyetje sqaruese.

Ju thatë që babai kishte një shembje në kokë. Dhe thatë këtu. Edhe po ju shihja. Dhe nuk e vura re çfarë më treguat?

Mund të ma thoni saktë ku te koka?

DËSHMITARI: Këtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra te balli? Në të majtë.

DËSHMITARI: Këtu. Rrahmje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në të majtë të kokës.

DËSHMITARI: Rrahmje. Këtu, nga mesi --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra nga mesi i ballit e lart.

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra, në mes të kokës, nga mesi i ballit dhe sipër.

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Nëse më lejoni znj. Prokurore.

Kam nevojë të pyes. Ju thatë se kur e patë babain në Kosovë, mund të na thoni kur? Kur ndodhi kjo?

DËSHMITARI: Diku nga fundi i -- qershorit, mendoj. Se -- me datë nuk jam i saktë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Mjafton për tani, faleminderit.

Fjala sërish për Prokurorinë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

PY. A vërejtët ndonjë gjë tjetër në gjendjen e tij fizike?

PË. Nga trupi, që u ra në killazhë. Domethënë ramje, me u dobësu. Ka tregu atëherë edhe shenja të tjera në dorë. Që ja kanë pre duart. Dhe sende të tjera brutale, me cigare, me krypë, e kanë bo në varrë. Të gjitha, të gjitha çka s’i bohen njerëzimit. Rrahje, prerje, venash të duarve.

PY. Përmendët cigaret. A ishte diçka që ju e patë vetë apo ua tregoi babai?

PË. Babai. Me cigare që e kanë djegë, domethënë, atëherë ka nisë premje të venat.

PY. Ju thatë që patë shenjat që ishin lënë nga prerja e duarve, më falni, a patë edhe të djegura në trupin e tij?

PË. Po.

PY. Ju na treguat për dëmtimin fizik që kishte pësuar babai nga ndalimi në Kukës. Kjo përvojë a pati ndonjë ndikim psikologjik tek ai?

PË. Po.

PY. Dhe çfarë ndikimi pati nëse mund të na tregoni?

PË. Ndikime të tjera, jo ashtu si e kamë njoftë unë ma herët. Edhe, psiqikisht s'është kanë ashtu. Domethënë, edhe ma gjatë kur ka patë trauma. Jo, ecjet qysh ka ecë përpara. Domethënë, dëmtime trupore.

PY. Ju na përshkruat në fillim, kur filluam të bënim pyetjet, ju na treguat si ka qenë babai para luftës. A mund të na tregoni si ishte pasi u kthye, mbase për nga karakteri çfarë kishte ndryshuar pasi u kthye?

PË. Mbas karakterit, me -- jo si është kanë kështu. U bëjke -- nervozitet, domethënë, nuk ishte ai që është kanë përpara çka -- si ka folë me fëmijët e vet.

PY. Më lejoni një pyetje të fundit.

Si ndikoi ndalimi i babait dhe përvoja e tij në Kukës tek ju personalisht, por edhe te familja juaj?

PË. Shumë keq. Shumë keq, për gjithë familjen.

PY. A mund të na tregosh diçka më shumë mbase mbi -- lidhur me pasojat, apo ndikimi që pati në familjen tuaj?

PË. Po, normale. S'kemi patë perspektiva. Motrat i kemi -- i kanë ndalu nga shkolla. Kanë krye shkollën e mesme, kanë patë

me vazhdu shkollën e lartë, i kanë ndalu nga shkolla. Puna që po ndodh diçka. Nga këto grupet që kanë ndodhë, nga Kukësi. Në Kukës e kanë ndodhë gjindja. Edhe ka patë frikë se ndodh diçka dhe ma e keqe familjare.

Po edhe te ne djemtë, tjetër perspektivë si një familje -- për disa gjind, jo për të gjithë -- kemi patë kontakte edhe me gjind të tjerë të mirë. Por disa gjind janë konë që -- si familje, si i thojnë, spiun. Prej kësaj që çka ka ndodhë te baba në Kukës. Por jo ata që na kanë njoftë. Ata që na kanë njoftë, e kanë ditë çfarë familje jemi. Edhe e dinë edhe sot.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia për dëshmitarin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

Z. Dëshmitar, Zyra e Prokurorit të Specializuar i përfundoi pyetjet e veta. Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtësi i Viktimave.

Mbrojtësi i Viktimave, fjala është për ju.

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

Z. LAWS: [Përkthim]

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Siç e dini unë jam Mbrojtësi i Viktimave për këtë çështje gjyqësore. Shumë pak pyetje kam për ju, sepse ju në fakt i jeni përgjigjur shumicës së pyetjeve që do ju kisha bërë edhe unë.

Thjesht dua disa detaje më shumë nga ju nëse mund të na

ndihmoni. Ju na treguat kur takuat babain e parë [sipas përkthimit] pasi e kishin liruar. Dhe ju vërejtët që ishte një person ndryshe. E mbani mend që na e thatë këtë?

PË. Po.

PY. Si ndikoi kjo tek ju personalisht, si u ndjetë ju kur e patë babain se si ishte shndërruar?

PË. Personalisht shumë keq. S'kam pasë qejf si baba ta shoh në atë gjendje.

PY. A mund t'ua përshkruani Gjykatësve si ndihej vetë babai juaj lidhur me ato çka i kishte ndodhur, si po i përjetonte ai vetë ndalimin që kishte ndodhur në Kukës dhe keqtrajtimin që i ishte bërë atje, pra, si po e përjetonte atë ai?

PË. Unë thashë edhe një herë. Shumë keq. Psiqikisht, ka ndryshu krejt, jo sikur përpara. Për të gjithë e lypte drejtësinë. Na e kemi vazhdu menjiherë, mbasi është kthyer, kemi vazhdu ku ta gjejmë drejtësinë.

PY. Pjesa e fundit e përgjigjes ishte pikërisht ajo që unë doja të dëgjoja. Babai juaj kërkonte drejtësi, na thatë.

PË. Po.

PY. Çfarë thoshte ai për këtë, çfarë thoshte më konkretisht ai për këtë aspekt? Për këtë drejtësinë?

PË. Gjithë e dojke drejtësinë, sikur m'u drejtu për t'i thënë diku këto sende. Çka i ka përjetu, çka i kanë ndodhë, edhe ata gjind të dalin para drejtësie. Ashtu të gjithë kemi kqyrë ku të drejtohemi në drejtësi. Fill pas lufte, edhe kemi qenë,

edhe s'jemi konë të sigurum sikur jemi këtu. Dhe kemi vazhdu për drejtësi.

PY. Faleminderit. Kaq pyetje kisha unë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Mbrojtësi i Viktimave.

Po shoh Avokatët Mbrojtës, është fjala për t'i drejtuar -- keni fjalën për t'i drejtuar pyetje dëshmitarit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Më lejoni pak momente që të organizoj materialet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Nuk ka përkthim]

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Përkthyesit nuk ju dëgjojnë shumë mirë, ju lutem të flisni me zë të lartë. Po, urojmë që në mënyrë që e keni tani mikrofonin, të jetë më e thjeshtë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Pyetje të palës tjetër nga z. AOUINI:

[Përkthim]

PY. Mirëdita z. Dëshmitar.

PË. Mirëdita.

PY. Siç e dini z. Dëshmitar, unë jam -- një nga Avokatët Mbrojtës të z. Shala dhe do t'ju bëj disa pyetje të sqarojmë disa aspekte. E keni të qartë këtë?

PË. Po.

PY. Shkëlqyeshëm. Sot më herët gjatë ditës ju na thatë, në faqen 58, rreshti 13 i transkriptit dhe në faqen 60, rreshti 3 i transkriptit, ju thatë se jetonit me të gjithë familjen në atë shtëpinë, nuk po e themi emrin më konkret, dhe as vendin, në momentin kur erdhën ushtarët tek shtëpia; kështu?
PË. Po.
PY. Z. Dëshmitar, edhe më specifikisht thatë, dhe kjo është në faqen 60, rreshti 14 deri në 15, ju thatë që vëllai i madh, nuk themi emra prapë, pra vëllai i madh ishte i pranishëm kur ndodhi ky incident, kjo ngjarje pra.
PË. Po.
PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që të keni thënë të kundërtën për vëllain e madh, rreth të njëjtës kohë vitin e shkuar? Pra, pak a shumë në të njëjtën periudhë vitin e shkuar. Pra i keni thënë të kundërtën hetuesve të ZPS-së. A ju kujtohet kjo?
PË. S'më kujtohet.

Z. AOUINI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, a mund të shfrytëzoj një deklaratë të mëparshme të dëshmitarit për të sqaruar disa papërputhshmëri.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, kur të merrni shifrën rendore të deklaratës së avokatit, të lutem ta vendosim në ekran.

Z. AOUINI: [Përkthim] Dua t'i tregoj dëshmitarit transkriptin në shifrën 105280-TR-ET, Pjesa 1, në faqen 14, rreshtat 13 deri në 19. Do t'ia jap pas pak çastesh variantin

në shqip.

Në variantin në shqip, është faqja 15, rreshtat 5 deri në 12.

PY. Z. Dëshmitar, a të kujtohet që i ke dhënë deklaratë hetuesve të ZPS-së vitin e shkuar?

Z. Dëshmitar, përqendrohuni në pyetjen time. Pasi do t'jua lexoj unë pjesën për të cilën do të flasim.

A të kujtohet të kesh takuar hetuesit e ZPS-së vitin e kaluar?

PË. [E padëgjueshme].

PY. Tani do të lexoj këtë pjesë të veçantë dhe dua të dëgjoj shpjegimin tënd mbi këtë, dakord?

PË. Po.

PY. Në rreshtin 13, dhe po citoj:

"Dhe kjo është diçka personale, ti ke qenë i pranishëm kur ka ndodhë kjo? Dhe këtë e kujtoni, këtë ngjarje e kujtoni në mënyrë të drejtpërdrejtë?"

Përgjigja është në rreshtin 15:

"Isha unë vetë, nëna ime, dhe vëllai im i vogël kanë qenë aty i pranishëm. Vëllai im i vogël ka hyrë brenda në shtëpi për ta bindur babain për ta dorëzuar armën."

Në rreshtin 18 është një pyetje tjetër:

"Dhe vëllai i vogël për të cilin po flisni" -- po ju lë ta lexoni pjesën tjetër të pasazhit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Vetëm në qoftë se të nderuar

Gjykatës dëshironi ta lexojmë pjesën tjetër duhet të kalojmë në seancë private. Mund ta lexoj unë. Por e lëmë në dorën tënde.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e shfrytëzojmë dot pseudonimin në këtë drejtim dhe do të na duhet të kalojmë në seancë private, por ta mbajmë sa më të shkurtër. Vetëm për këtë pjesë të shkurtër dhe të kthehemi në seancë publike edhe një herë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Dakord.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja Sekretare a mund të kalojmë në seancë private ju lutem?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Avokati Mbrojtës mund të vazhdoni.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

PY. Z. Dëshmitar, ju thatë pak më herët sot që një nga ushtarët ju mori armët nga shtëpia, dhe kjo është në faqen 63, rreshtat 6 deri në 8.

Pyetja ime është: A ka hyrë në shtëpi ndonjë nga ushtarët, a ka hyrë brenda në shtëpi për ta marrë këtë armë, apo si ka ndodhur?

PË. Vëllai i vogël ka shku, ka hi mbrendë dhe e ka lutur babën vëllai, motra, motrat e mia, që ta jepë atë armë për të mos ndodhur diçka e keqe.

PY. Faleminderit. Pra ju konfirmoni që asnjë ushtar nuk ka hyrë brenda në shtëpi. Kjo ishte pyetja ime.

PË. Në shtëpi po, në oborr, e jo mbrendë në shtëpi. Por në oborrin e shtëpisë. Ajo pronë është prej gardhit atje, deri te shtëpia, krejt pronë e jona. Veç se s’e kanë pa babain, ata babain e kanë lypë, dhe e kanë dashtë babain për t’u takuar. Por s’kemi dashtë ne me e bo -- ish ardhë edhe ma e keqe.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Folët për oborrin dhe gardhin e shtëpisë, dhe dua që t’ju tregoj një fotografi.

Z. AOUINI: [Përkthim] Që është në shifrën DPS00065.

PY. Z. Dëshmitar, mos përmendni emrat e vendeve. A e njeh këtë fotografi, a e dallon këtë fotografi?

PË. Po. Por ka ndryshime këtu. Në këtë foto ka ndryshime, sikur është kanë rasti kur ka ndodhë.
PY. Do të vijmë tek ajo pikë, por duhet të konfirmoj. A është ky vendi ku ka ndodhur incidenti?
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Pa përkthim]
DËSHMITARI: [Mikrofoni çaktivizuar] -- vendi ku ka ndodhë incidenti dhe ku kam banu në atë kohë që ka ndodhë në 1998. Kemi banu na edhe ma herët në këtë shtëpi, jo veç në 1998.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të sugjeroja që herën tjetër të fillonim me një pyetje të hapur. A mund që të tregoni se çfarë shihet këtu, dhe më pas do të kalojmë në mënyrë më specifike në çështje më specifike.
Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit znj. Kryetare.
PY. Në këtë fotografi a shihni një gardh?
PË. Këta tela unë vetë me dorën teme dhe me babën i kam bo. Mbas lufte. Përpara është kanë gardh. Gardh i thojnë me dru që është, këta shtyllat edhe druni kështu.
PY. Po, kjo ishte pyetja ime. E kuptojmë tani që gardhi nuk është njësoj siç ishte në kohën e incidentit. Dakord?
PË. Ashtu. Këtë e kam bo mbas lufte.
PY. A mund të thuhet e njëjta gjë edhe për portën që të çon në oborr?
PË. Porta ka qenë këtu ku është. Domethënë, prej kësaj këtu ku është kanë gardhi që ka ndryshu në tela, e kemi bo, këtu është kanë një portë e drurit që çelet dhe mshelet. Këtu është

kanë rrugë kerri që ka hi deri në oborr. Kjo pronë këtu te gardhi dhe telat këtu janë tonat. Unë i kam ndukë këta tela, këta drunj, me dorën teme, me babën tem. Diku mundem me thanë 2002 apo 2003.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të preferoja që të përdornim lapsin me qëllim që ta kuptojmë këtë në procesverbal, pasi kemi diskutuar edhe për çështjen e gardhit, edhe për çështjen e portës dhe dua t'i shënojmë me numra këto në fotografi për ta pasë sa më të qartë situatën.

Znj. Asistente e Gjykatës, a mund ta ndihmoni dëshmitarin.

Z. AOUINI: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, do të doja të shfrytëzonim një laps apo stilolaps në fotografinë e ardhshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ndoshta mund ta bëjmë këtë shkurtimisht -- që të përdorim shifrën 1 dhe 2 për sa i përket gardhit dhe portës. Pasi edhe në këtë fotografi duket më shumë se sa një gardh. Dhe po të -- në qoftë se doni të krahasoni me dëshmitarin e mëparshëm jua lë juve ta merrni këtë vendim, por për sa i përket kësaj fotografie, do të ishte me vlerë që ta shënonim ashtu pasi më vonë ne nuk jemi së bashku dhe nuk shohim të njëjtën gjë në të njëjtën kohë.

Z. Dëshmitar, a mund të shkruash numrin 1 në pjesën e gardhit të cilin kemi diskutuar, pra të gardhit të cilin ti e ke ndërtuar së bashku me babain pas luftës.

DËSHMITARI: Po, nji tash [Shënon].

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Z. Dëshmitar.

A mund të shkruash numrin 2 në vendin ku ka qenë porta, ku ka qenë apo ku është porta, porta të cilën kemi -- po diskutojmë këtu.

DËSHMITARI: [Shënon]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Çdo gjë e qartë.

Avokati Mbrojtës, ju e keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Kryegjykatëse.

Kalojmë deri në fotografinë tjetër që ka shifrën 00066 [siç e tha përkthyesi], për të cilën një pyetje tjetër, megjithatë e kam parasysh edhe kohën që ka në dispozicion Mbrojtja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ta ruajmë së pari këtë fotografi, znj. Sekretare.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, e kemi -- e ruajtëm këtë me shifrën DPS00065 do të ruhet në Legal Workflow me numër REG00043 [siç e tha përkthyesi].

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Avokati Mbrojtës, ju e keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Kryetar [sipas përkthimit] është i njëjti vend këtu. A

mund të vlerësoni se sa është distanca nga porta deri tek shtëpia juaj? A mund ta vlerësoni sa është kjo distancë?

PË. Kjo është 25 deri në 30 metra. Po ne i kemi thanë oborr, krejt oborri jonë këtu është i joni, edhe mbas shtëpie andej. Po ajo shtëpia e vogël që është aty, ajo u bo mbas lufte. Edhe të tjerat anash këha, janë mbas 2002, 2003. Edhe kur [e pakuptueshme] në të majtë kur të hysh në portë, edhe ky është në 2004, 2005. Shumë mbas rasteve.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka një gabim, apo gabim përkthimi. Thoni "pas vitit 2023".

Faleminderit.

Ju e keni fjalën Avokati Mbrojtës.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, kaloj tani në një temë tjetër.

Dhe po i referohem faqes 63 të transkriptit, nga rreshti 13 deri në faqen 64, rreshti 1. Ju na thatë z. Dëshmitar se keni mësuar nga babai për Pjetër Shalën shumë më pas luftës. A e kam përmendur si duhet atë që thatë më herët?

PË. Po. Ama si Komandant Uki e kemi njoftë edhe përpara. Por nuk e kemi ditë që ka qenë ai aty. A njoftë, s'e kemi si person, por si Komandant Uki e kemi ndëgju. Si u ka qenë në Jabllanicë. Uki apo Ujku, si i kanë thanë.

PY. Z. Dëshmitar, babai juaj është i vetmi person që ju ka treguar që z. Shala ka qenë i pranishëm në atë incident?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Pyetje ishte kjo?

Z. AOUINI: [Përkthim] Dua konfirmimin e tij.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Preferoj që të bëhet në formën e pyetjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Do t'jua bëj si pyetje atëherë.

PY. Z. Dëshmitar, a e keni mësuar këtë informacion lidhur me praninë e Ujkut, Ukit, apo Pjetër Shalës, në këtë incident të vitit 1998. Pra, a ishte babai burimi i vetëm i këtij informacioni?

PË. Në 1999, në Kukës, u ditke kush është, ai vetë i ka thënë, "Unë jam ai. Kur erdha te shtëpia, pse s'dole. Unë jam ai që ta kam gjujtë *[REDAKTUAR]*.

PY. Z. Dëshmitar, mos më keqkupto, dëgjo me vëmendje pyetjen që po të bëj. Keni treguar lidhur me fjalët që ka shkëmbyer sipas teje Shala me babain e tij, pyetja ime ishte që: informacionin lidhur me praninë e Pjetër Shalës në incidentin e vitit 1998, a e ke dëgjuar vetëm nga babai. Përgjigjja mund të jetë po ose jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund ta bëjmë ndryshe, Avokat Mbrojtës.

Z. Dëshmitar, kush të ka thënë ty që z. Shala ka qenë i pranishëm atje? Kush ishte burimi i këtij informacioni?

PË. Babai.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ndonjë tjetër, ta ka dhënë këtë informacion?

DËSHMITARI: Po. Veç babai dhe familja që kanë dëgju.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ia jap sërish Avokatit Mbrojtës.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. A u bë ndonjëherë ndonjë hetim kush ishte i pranishëm atje? Domethënë, familja juaj, a bëri ndonjëherë ndonjë hetim kush ishte i pranishëm atje, pasi ndodhi, fill pas incidentit?

PË. Babai. Vëllai i madh ka pyt -- dhe ka ndëgju ndër tjerë, ish-luftëtarë çka janë kanë, që ai ka qenë atje. Por unë i kam besu fjalëve të babait. Se vetë i ka thënë Pjetër Shala, Komandant Ujku, i ka thënë si, "Unë jam ai. Pse ke lypë tjetërkah, se unë jam ai që ta kam gjujtë *[REDAKTUAR]*", edhe "Unë jam ai, që jam ardhë te shtëpia, pse s'dole kur kam ardhë te shtëpia". Për rastin në 1998 në -- ku kemi banu.

PY. Z. Dëshmitar, pra kjo s'ishte hera e parë që dëgjuat këtë nofkë pas lufte, hë? Saktë?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë doni të dini nga dëshmitari?

Z. AOUINI: [Përkthim] Dua të di periudhën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë, kërkoji periudhën. Mendoj se pyetja është pak e paqartë. Dil në thelb.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PË. Kur e bëri këtë hetimin familja juaj? Në ç'periudhë?

PY. Hetimin e ka bo babai kur ka dëgju në Kukës, por nofkën

si po thu ti, Ujku, na e kemi dëgju edhe përpara, që Komandant Ujku është në Jabllanicë. Por ne, nuk kemi patë informata se Komandant Ujku apo Pjetër Shala u konë te ne për të sulmuar. Babai -- mbas rastit, babai e ka vërtetu babai vetë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, përgjigjuni pyetjes së mbrojtjes. "Kur", "kur" është pyetja. Kur e bëri këtë hetimin babai juaj.

I drejtohemi edhe Avokatit, a është kjo ajo që doni të dini?

Z. AOUINI: [Përkthim] Më shumë e kisha të përgjithshme pyetjen për familjen, më shumë isha i interesuar te familja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptoj ku doni të dilni, por mbase nuk e ka kuptuar z. Dëshmitar pyetjen. Dhe unë njësoj si ju do isha përgjigjur në fakt.

Z. Dëshmitar. Kur e hetoi familja kush ishte ky person, pra kur e bëri familja këtë hetim për të zbuluar kush ishte ky person?

DËSHMITARI: Mbasi u liru babai nga fabrika e metalit në Kukës. Mbasi ka ardhë babai te shtëpia, jua ka tregu familjes, por unë s'kam qenë në Shqipni, unë kam dëgjuar kur janë kthyer nga Shqipëria në Kosovë, në fshatin ku, si thojnë, ka lindë babai. Aty e kam dëgju unë, nga familja dhe babai.

Z. AOUINI: [Përkthim] Me lejen tuaj, të nderuar Gjykatës, do të doja të kalonim në seancë private, për të lexuar një

pjesë që të dal në thelb, siç dhe më sugjeruat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, ju lutem dhe na thoni për cilën deklaratë e keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] ERN 105280 -- e përmendëm dhe më herët. Një faqe më pas. Faqja 15, pra, rreshti 5. Faqja 15, rreshti 10 deri në 13, në shqipe, janë faqet 8 deri në 17. Sepse mbulon pikërisht këtë aspekt që dua të diskutoj.

Ju kërkojmë falje, është faqja 16.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Pa përkthim]

Z. AOUINI: [Përkthim] Faqja 16. Në anglishte, faqja 16, rreshtat, 10 me 13.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Vazhdoni ju lutem.

Z. AOUINI: [Përkthim] A mund t'ia lexoj dëshmitarit?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. "E mbani mend pas faktit që e morën këtë, ju thatë?"

"Po, ne e dinim pseudonimin e tij, ishte nofka "Ujku". Dhe ju pyeta, "Por pas sa ditësh e mësuat?" dhe ju thatë "Dy-tri javë pas incidentit, e morëm vesh këtë informacion".

PË. Kjo s'është e vërtetë. Ka mundësi se ka dhe të shkrume përkthimi i gabum. A kjo është mbas rastit të babës kur u liru, kur u ardhë në Kosovë, unë e kam ditë që është Pjetër Shala. Si nofka Ujku, e kam ditë unë edhe përpara, por s'e kam njoftë kur është Ujku, veç kam dëgju nga kojshitë. Por si

Pjetër Shala, si është kanë te na apo ka ndodhë diçka te babai në Kukës a si, na as e kemi njoftë, as e njoh. As mbas anejni, as e kam pa kurrë përpos kur e kanë qitë si për Gjykatë. Aty e kam pas i fotografi, se nuk e kam njoftë përpara. Veç prej babait, ça ka tregu.

Z. AOUINI: [Përkthim] Dëshiroj të lexoj pjesët që i paraprinë kësaj, që të kuptojmë përgjigjen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni ju lutem Z. Avokat.

Z. AOUINI: [Përkthim] Në faqen 16 në anglishte, rreshti 8.

PY. "PË. Dhe vëllezërit e mi -- dhe vëllai im."

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jemi në seancë publike, ju lutem. Doni të kalojmë në seancë private?

Znj. Sekretare e Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private ju lutem?

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F541*

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë private, por do t'i luteshim Avokatit Mbrojtës të na konfirmojë cila është faqja në gjuhën shqipe.

Z. AOUINI: [Përkthim] Për shqipen, duhet të jetë e njëjta, faqja 16. Besoj rreshti 6, 7.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull atëherë.

Vazhdoni ju lutem.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Do ta lexoj. Përgjigja, rreshti 8:

"Edhe *[REDAKTUAR]*, domethënë e ka hetu dhe ai thotë që është kanë Pjetër Shala.

Z. Dëshmitar, a është përkthim i gabuar ky apo është i saktë? Si mendoni?

PË. Ky është përkthim i gabuar. I kam paralajmëru edhe -- që ka gabime ku kanë dhanë bisedë, prej përkthimeve. Po kjo pas tri javëve, si është. Këtë s'e kam -- unë di veç nga baba kur u liru nga fabrika e metalit, prej burgut, apo arrestimit që i kanë bo.

PY. Shumë e qartë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Mirë atëherë, kalojmë në një aspekt tjetër që mund ta bëjmë në seancë publike. Më falni. Edhe një pyetje para se të kalojmë në seancë publike. Sepse dua të pyes për një emër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni Avokati Mbrojtës.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë për këtë.

PY. Z. Dëshmitar, ju thatë që e mësuat atë që i kishte ndodhur babait tuaj pasi u kthyet nga Shqipëria; kështu?

PË. Po.

PY. 17 ishte kjo [sipas përkthimit]. Më falni, në faqen 70, në rreshtat 13 dhe 14.

Z. AOUINI: [Përkthim] Te transkripti i sotëm po flasim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po shikoja versionin në shqip, tek provat -- dy deklaratat mund të hiqen. Okej.

Vazhdoni ju lutem, Avokati Mbrojtës.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, a e njihni ndonjë me emrin -- *[REDAKTUAR]*?

PË. Po. *[REDAKTUAR]*, po.

PY. Çfarë lidhjesh keni me të?

PË. Shumë të mira. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, se ai tjetër mbiemër ka, na e kemi Kuqi.

Ai më ka lajmëru, pa ardhë baba, më ka lajmëru që "Babën ta kanë kidnapu, por mirë është, kam ndëgju që është apet i lirë". Ai ka qenë në Shqipni. Ka ndëgju prej gjindve.

PY. Faleminderit, në fakt edhe atë në një përgjigje ju iu përgjigjët shumë pyetjeve të mia.

Pra mësuat përpara se të kthehej babai dhe familja nga *[REDAKTUAR]* ju e morët vesh çka i kishte ndodhur babait tuaj, kështu?

PË. Po. *[REDAKTUAR]* më ka tregu diçka por jo ashtu si ka ndodhë.
Por ka thënë, *[REDAKTUAR]* më ka thënë që diçka ka patë probleme,
por jo të gjitha që e kanë kidnapu, që e kanë arrestu, që jo -- nuk m'i ka tregu të gjitha. Veç ka patë diçka probleme, e të gjitha i kam -- dëgju nga babai. Mbasi u kthy.

PY. Z. Dëshmitar, ju na thatë se *[REDAKTUAR]* e kishte marrë

vesh nga dikush tjetër. E dini ju gjë? Nga kush e kishte marrë vesh ai?

PË. Nuk e di. Ai ka qenë në Shqipni. *[REDAKTUAR]* si i thojnë, është ardhë nji ditë a dy para babës. E kam taku, si je a je mirë, a je gjallë? Si takohen kur s'e sheh njërin në luftë gjatë, a ka pështu, apo ka vdekë. Ajo luftë është kanë. U taku me mu në katundin atje që jetoj, edhe i ka hikë kësaj bisede. Si: "Ka patë diçka probleme në Shqipëri, por t'i tregon babai kur të vjen vetë". Por ai nuk e ka dëgju nga babai, por ka dëgju nga -- nuk e di unë nga kush. Ai ka qenë vetë në *[REDAKTUAR]*. Edhe normal si ka dëgju diku, se e kanë kidnapu se *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Sot më herët gjatë ditës, ju na thatë se edhe ju personalisht dhe vëllai i madh e njihnit dikë nga personat që ka qenë i përfshirë në kidnapimin e babait tuaj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutemi na e jepni transkriptin.

Z. AOUINI: [Përkthim] Rreshti 70 -- më falni, faqja 7 [siç e tha përkthyesja], rreshti 21 deri 22.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, e njihni emrin Bashkim Lama?

PË. Po. Shumë mirë. Edhe e njoh kështu.

PY. Për këtë person e kishit fjalën ju, pra ky është ai personi që ju personalisht dhe vëllai më i madh e njihnit?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të japësh pak më shumë kuptim, kontekst?

DËSHMITARI: Këtë e njohim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se ju thoni: "A është ky personi që përmend -- që i referoheni ju, që ju dhe vëllai juaj më i madh e njihnit?"

Për herën tjetër -- ne e morëm përgjigjen. Por është e mira ta vendosni në kontekst.

Z. AOUINI: [Përkthim] Znj. Kryegjykatëse, mbase këto pyetje mund t'i bëjmë në seancë publike. Sepse ne e dimë tani për kë person do të flasim, duhet të mos përmendim emrin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni çaktivizuar]

Po shoh nga ana e Prokurorisë.

Bashkim Lama, si mendoni ju a mund ta bëjmë seancë publike?

Z. AOUINI: [Përkthim] Pa thënë emrin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk do ta themi emrin, por unë dua edhe pikëpamjen e tyre lidhur me këtë pikë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ne e dimë që kjo është redaktuar, por do të hiqet redaktimi tek dosja paraprake që ne do të

dorëzojmë sikurse edhe na u udhëzua dje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse kuptova siç duhet, ju po thoni që emri Bashkim Lama mund të përdoret në seancë publike?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Atëherë z. Avokat, e kemi zgjidhjen para syve. Jemi në seancë private, do kalojmë në seancë publike. Do ju lutesha znj. Sekretare të Gjykatës të na kalojë sërish në seancë publike.

Dhe është mirë që po përpiqemi sa më shumë që seancën ta kemi publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Avokati Mbrojtës, mund të vazhdoni.

Z. AOUINI: [Përkthim] Përpara se të vazhdoj, bazuar në ato çka u diskutuan, do të kërkoja që emri që është redaktuar ditën e parë të seancës, të hiqet tani. Ky ishte një nga udhëzimet që u dhanë në mesditën e ditës së parë që filluan dëshmitë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, do ta bëjmë këtë sapo të jetë e mundur, do të riklasifikojmë çdo gjë që mund të riklasifikohet. Është detyra jonë kjo. Por e kuptoj çfarë doni të thoni, sidoqoftë ju

garantoj që është një përparësitë tona kryesore.

Vazhdoni me pyetjet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, ju na thatë se ju personalisht dhe një person tjetër nga familja juaj e njihnit këtë personin me emrin Bashkim Lama. A mund të na e përshkruani shkurtimisht marrëdhënien që kishit me të?

PË. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

PY. Nuk kam nevojë për hollësi të tjera.

Por unë pyetjen e kam: Ju vetë, a folët me këtë person, a e takuat më ndonjëherë pas lufte këtë person?

Fokusohuni vetëm tek pyetja që të mos na jepni informacione të tjera konfidenciale.

PË. Jo. Jo.

PY. Ju personalisht dhe vëllai më i madh, a u përpoqët t'i merrnit një shpjegim këtij personit që e ju e njihnit të dy, pse, për çfarë i ndodhi kjo babait tuaj? Flasim pas lufte, i referohem periudhës pas luftës.

PË. Pas lufte na kemi ndjekë veç drejtësinë. Nuk kemi hi

privat, se ai u konë i përlyer me ato grupe që i kanë bo këto sende. Atë s'ke ça të folësh me të. Ai bo vaki me e patë shansin kishte bo edhe të tjera sende.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Do kaloj te një linjë tjetër pyetjesh.

Po ndonjë me emrin Gani Shehu, a e njeh?

PË. Gani Shehu. E njoh, por kurrë s'kam patë kontakt me të, *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, vetëm përgjigjuni pyetjes. Nuk keni pse jepni informacione të tjera përveç nëse jua kërkon vetë Avokati Mbrojtës.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, është mirë të veprojmë kështu sepse mund ta dimë çfarë mund të themi në seanca publike, dhe në seanca private. Nëse duam më shumë hollësi, do ju pyesim ne.

Babai juaj, a ju tha ndonjëherë ndonjë gjë për rolin që ka pasur Gani Shehu gjatë luftës?

PË. Jo, personalisht te unë jo.

PY. A morët vesh prej babait apo prej ndonjë pjesëtarit të familjes që Gani Shehu ishte shfaqur -- në njëfarë mënyre në historinë e babait tuaj në Shqipëri, diku në atë që i kishte ndodhur babait tuaj në Shqipëri, ishte shfaqur edhe ky person?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur flasim -- themi historia, më duket se unë e nën -- kuptoj se

çfarë doni të thoni ju, por nuk dua t'ju shtjelloj unë më tej.

Z. AOUINI: [Përkthim] Po përpiqemi të jemi sa më të përgjithshëm që të jetë e mundur. Historia në Shqipëri e kemi fjalën për çdo gjë që i ka ndodhur në Shqipëri. Dëshmitari s'ka qenë vetë atje, por e kemi fjalën për të gjithë historinë, fillim, mes, fund. Pyetja është e hapur. Është një emër dhe duam të dimë a është përmendur ndonjëherë emri i këtij personi lidhur me këtë histori.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala histori është shumë e përgjithshme. Tepër e përgjithshme. Mund të thoni nga momenti që jetuan atje dhe u larguan.

A ka -- domethënë pyetja lidhet me periudhën kur ka jetuar babai në Shqipëri? A i doli ndonjëherë ky emër? Është shumë e përgjithshme, duhet t'i lidhni. Duhet ta lidhin me aktakuzën. Mund ta bëjmë në seancë private në qoftë se është nevoja. Por kjo pyetje është më e hapur se ç'duhet dhe nuk përkufizohet siç duhet termi "histori".

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Babai juaj, apo ndonjë person tjetër, që mund ta ketë marrë vesh nga babai juaj, ngjarjet e kidnapimit të tij dhe transportimit të tij, deri në momentin që u lirua dhe deri në kthimin në Kosovë, ndokush ju ka treguar... pra ju thatë "S'ma ka thënë personalisht ai", ju ka treguar ndonjë njeri për rolin dhe përfshirjen që ka pasur Gani Shehu lidhur me babain tuaj, në raport me babain tuaj?

PË. Jo.
PY. A mbani mend t'ju ketë treguar ndonjëherë babai ndonjë gjë për ndonjë person me emrin Majk, ose Majkëll, hetues ose gazetar.
PË. Unë personalisht jo.
PY. Babai juaj, a përmendi ndonjëherë, a ju përmendi ju ndonjëherë personalisht ndonjëherë një shtëpi të verdhë në Shqipëri?
PË. Jo.
PY. Babai a ju -- ka thënë ndonjëherë të jetë transportuar me një Mercedes të verdhë drejt ose nga Durrësi? Drejt Durrësit apo nga Durrësi?
PË. Jo.
PY. Z. Dëshmitar, a mbani mend të keni dhënë një deklaratë për hetuesit në vitin 2003?
PË. Po.
PY. A pajtoheni me mua në qoftë se unë ju them se ju atë ditë s'e keni përmendur asnjëherë emrin Pjetër Shala, pra atë ditë kur takuat hetuesit?
PË. S'më kujtohet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të përdor deklaratën për t'i rifreskuar kujtesën dëshmitarit, meqë atij vetë nuk i kujtohet, pra thjesht për të kuptuar ose për të treguar që nuk është përmendur emri i Pjetër Shalës në deklaratën e 2003.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse e kuptova siç duhet unë, ju i thatë atij që: "S'e keni përmendur z. Shala në deklaratën e vitit 2003". Dhe dëshmitari po thotë "S'e di". Por mbase duhet ta sqarojmë çfarë nuk di. Se nuk e kam të qartë çfarë nuk di.

Z. AOUINI: [Përkthim] Unë dëgjova që tha që nuk më kujtohet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Okej, dakord. E perifrazoj -- e riformuloj. Doja të thoja kur tha: "Nuk e mbaj mend", unë dua të di çfarë nuk mban mend.

Z. Dëshmitar, çfarë nuk të kujtohet? Çfarë s'të kujtohet më?

DËSHMITARI: Për rastin 2003, nuk më kujtohet se kam patë shumë ku kemi folë, shembull, kemi patë me UNMIK ma herët, me shumë -- me drejtësinë -- ku janë ardhë e kanë fol, por nuk më kujtohet saktë si, çka kanë folë me atë apo çka kam folë me këtë. Të gjitha nuk më kujtohet. Për realitetin po e kallzoj çka e di vetë personalisht. E çka kam dëgju prej babait, i tregoj këtu. A nuk më kujtohen të gjitha. Na kemi patë shumë -- domethënë me drejtësinë, me ato, me këto, ka patë raste kur kemi çu veç babain, ne s'jemi marrë në pyetje hiç. Tashti unë nuk muj i di -- nuk muj i kujtoj të gjitha. Ku e kam përmendë Pjetër Shalën e ku s'e kam përmendë. Ka pat edhe gjind të tjera aty. Nuk është kanë veç rasti i Pjetër Shalës. Është -- a muj i përmendni emrat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

Avokati Mbrojtës ju e keni fjalën dhe mund të kërkoni që të ngarkojmë në sistem deklaratën e 2003.

Znj. Sekretare e Gjykatës ju lutem ta vendosni në ekran këtë deklaratë ku me -- sapo të keni marrë referencën e duhur.

Z. AOUINI: [Përkthim] Deklarata, SPOE00047605.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat Mbrojtës, jam i sigurt që e keni parasysh sa kohë kemi në dispozicion. Dhe siç e thashë më përpara këtu nuk jemi në një dyqan, dhe nuk do t'jua ndërpres fjalën që tani. Por duhet ta di edhe sa kohë do t'ju nevojitet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pas kësaj deklarate, kam vetëm një seri të shkurtër pyetjesh dhe kaq. Nuk besoj se do të më duhen më shumë se 10 apo 15 minuta në varësi të kësaj që do të dëgjojmë më pas.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

Kalojmë në faqen 4, në mes të faqes. Më kanë thënë që është ngrirë transkripti.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Seancës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Transkripti nuk punon për tërë palët këtu. Kështu që, na duhet

të presim një çast për të parë se cila është arsyeja me qëllim që ta vëmë në funksionim sa më shpejt të jetë e mundur që të na mundësohet vazhdimi më tutje.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Seancës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më kanë treguar se si është puna. Duhen 15 minuta për të rinisur sistemin, kështu që unë propozoj që të bëjmë 15 minuta pushim dhe të vazhdojmë për gjysmë ore pasi të pyesim Njësinë e Administrimit të Gjykatës nëse do të jemi në gjendje të shfrytëzojmë sistemin pas kësaj. Pra do të na duhen të paktën gjysmë ore.

Z. Shala, kemi një vonesë prej gjysmë -- prej çerek ore.

Z. Dëshmitar do të marrim një pushim prej 15 minutash --

DËSHMITARI: *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, ajo që thashë --

DËSHMITARI: *[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- isha duke folur me të akuzuarin. Por tani jam duke folur me ju dhe prandaj po ju drejtohem si “z. Dëshmitar”.

DËSHMITARI: Më falni.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e kisha fjalën për ju. Po i shpjegoja z. Shala që do të kemi një pushim prej 15 minutash, dhe tani po të drejtohem ty. Z.

Dëshmitar që do të bëjmë pushim prej 15 minutash për të zgjidhur këtë çështjen teknike, dhe do të vazhdojmë më pas edhe për gjysmë ore tjetër. Ose ndoshta pak më shumë, në varësi të kohës që do të na lejohet.

Dhe tani do t'i kërkoj Asistentes së Gjykatës që t'ju shoqërojë të dilni nga salla e gjyqit për këtë pushim 15 minutash, pas së cilës do t'ju kërkojmë të vini sërish këtu.

A e keni të qartë?

DËSHMITARI: Faleminderit, më fal. Që kur e the emrin më kqyre dhe deshta ta tregoj. Faleminderit, më fal.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Asistentes së Gjykatës, pushim prej 15 minutash. Të gjithë në këmbë.

--- Pauza fillon në orën 15.38

--- Seanca rifillon në orën 15.57

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se vini edhe njëherë pas këtij pushimi të shkurtër. I kemi shpjeguar tashmë se ku ndodhemi nga pikëpamja logjistike.

Znj. Asistente e Gjykatës, ju lutem na sillni në sallë dëshmitarin.

E shoh ndërkohë që jeni të njëjtit njerëz për të gjithë ekipet. Z. Shala na ndjek me videolidhje.

Z. Shala, a më dëgjoni? Po pohoni me kokë. Por dua ta dëgjoj këtë konfirmim me zë për të parë që e kemi në lidhje në

rregull.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mirë se vini edhe njëherë.

A më dëgjon?

DËSHMITARI: Po. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'ia jap fjalën edhe njëherë Avokatit të Mbrojtjes.

Avokati Mbrojtës dëshironi që të jemi në seancë publike apo private?

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse. Do të lexoj këtë deklaratë dhe do të varet nga ju nëse dëshironi ta bëjmë në seancë publike apo private. Paragrafin para syve. Nuk shoh arsye për ta bërë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për cilin paragraf e keni fjalën? Cilin paragraf e keni fjalën?

Z. AOUINI: [Përkthim] Paragrafi i tretë nga fillimi, aty ku fillon me fjalën "Babai im" dhe përfundon me "emrat e tyre".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund ta bëjmë në publik këtë dhe shoh edhe Zyrën e Prokurorisë që pohon me kokë.

Kështu që vazhdoni, Avokat i Mbrojtjes.

Z. Dëshmitar, dëgjojeni me vëmendje.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, do të dëgjoj një pjesë të deklaratës për të cilën folëm më herët, deklaratën e 2003 të cilën e keni dhe në ekran përpara.

"Babai im më tha më tutje se ishte ndaluar në një burg të improvizuar ku persona të UÇK-së e kishin keqtrajtuar. Ai më tha se e kishin rrahur me shkop bejzbolli në të gjithë trupin. Gjithashtu ai më përmendi edhe personat e mëposhtëm që kishin marrë pjesë në keqtrajtimin e tij; Xhemshit Krasniqi, Fatmir Limaj dhe Jakup Krasniqi. Kishte edhe shumë autorë të tjerë krimi por nuk ua mbaj mend emrat".

Z. Dëshmitar, ky është viti 2003 edhe më afër në kohë me ngjarjet në fjalë dhe në momentin që babai juaj kishte zbuluar emrin e Pjetër Shalës, megjithatë emri i Pjetër Shalës nuk ndodhet i përmendur këtu apo jo?

PË. Po. Ajo a kanë kur pyetjen ma kanë bo për Xhemshit Krasniqin. Se unë e thashë edhe njëherë, janë kanë shumë raste ku kam dhënë deklarata. Shumë pyetje më kanë bo shumë tjerë, jo veç një, prokurori, si i thojnë.

Xhemshit Krasniqi u konë. Domethënë këtu ku e kam cekë Fatmir Limaj a konë, po s'a kanë në rrahje që e ka keqpërdorë e keqtrajtu. Domethënë Jakup Krasniqi a kanë aty, po s'a kanë në rrahje e keqtrajtu.

Xhemshit Krasniqi, Pjetër Shala dhe Sabit Geci a kanë. Po nuk më kanë pyet për ta. Fjala a kanë kur më kanë pyet për Xhemshit Krasniqin në atë kohë. Pastaj janë edhe tjera deklarata ku i kam dhanë.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A konfirmoni që më *[REDAKTUAR]* 2003, hetuesit e Tribunalit të Hagës ju kanë pyetur dhe ju kanë marrë deklaratë nga ana jote lidhur me Xhemshit Krasniqin?

PË. Nuk e di. S'më kujtohet kjo. Por ka raste shumë kur kam përmend, domethënë, këta Xhemshit Krasniqi, Pjetër Shala, Sabit Geci që kanë marrë pjesë në rastin e babës dhe keqtrajtimin e babës. Për këta tjerët thotë që janë kanë aty Jakup Krasniqi, Fatmir Limaj, po në rastin e keqtrajtimit s'kanë marrë pjesë. Ashtu prej babës çka kam ndi.

PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat i Mbrojtjes, pyetja juaj në faqen 3 të transkriptit të papërfunduar, rreshtat 13 dhe 14 dhe 15, kërkon nëse dëshmitari mund të konfirmojë që hetuesit e TPNJ-së e kanë pyetur dhe kanë marrë deklaratë nga ai lidhur me Xhemshit Krasniqin.

Me sa kam kuptuar unë, kjo deklaratë, po të shkoj në dokumentin 00047606, nuk ka nevojë që ta vendosim në ekran, por është faqja e parë e kësaj deklarate, ku thuhet që:

"Unë do t'ju flas lidhur me disa incidente që kanë të

bëjnë me kidnapimin e babait tim" në një datë të caktuar. Dhe "për ngjarjet që kanë ndodhur më parë".

Kjo deklaratë është marrë në lidhje me këtë çështje dhe këtu përfshihet emri i këtij personi. Kështu e kuptoj unë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Jemi dakord, të nderuar Gjykatës. Por përgjigja e dëshmitarit ishte -- po të më lejoni do ta citoj fjalë për fjalë, përgjigja e cila ka bërë që të bëjë unë këtë pyetje kaq të posaçme.

Faqja 3, rreshti 2 dhe 3:

"Kjo më ka ndodhur kur më kanë pyetur për Xhemshit Krasniqin".

Pra, na takon neve që të kërkojmë datat dhe shpjegimet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dakord. Po duhet ta paraqesim si duhet në procesverbal se cila është kjo deklaratë dhe cili është fillimi i kësaj deklarate.

Vazhdoni, Avokat i Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, po tani po kalojmë në një dokument tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem ta hiqni nga ekrani këtë dokument.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, përpara pushimit në faqen 108, rreshtat 11 dhe 12, na the që:

"Ka patur disa çështje gjyqësore për të cilat e kemi çuar babain për t'u marrë në pyetje..."

Për këtë po flisnim para pak çastesh. A mund ta konfirmosh që kështu është?

PË. Po. Ka patë raste kur më kanë pyt veç për Xhemshit Krasniqin. Ka patë rast kur më kanë pyt për Sabit Gecin. Ka pat rast, po, kam patë me -- shumë e kem ndjekë gjithkund drejtësinë. Ka patë rast që jam kanë në Prizren. Ka patë rast që kanë ardhë te shtëpia në pyetje më kanë marrë. E tash s'mundem me i cek unë për çka më kanë pyet ashtu jua kam dhanë përgjigjen.

PY. Po, z. Dëshmitar. Z. Dëshmitar, ti personalisht a ke marrë pjesë në seancat kur është marrë në pyetje babai yt?

PË. Jo.

PY. A ke diskutuar me babain lidhur me përmbajtjen e deklaratave të tij apo pyetjeve që i janë bërë?

PË. Jo, nuk na i ka tregu.

PY. A dini nëse babai juaj ka mbajtur shënime lidhur me deklaratat e tij apo seancat e pyetjeve në të cilat është marrë.

PË. Në seanca ka marrë në pyetje kur a kanun, unë s'jam kanë gjithë me të. Ka qenë *[REDAKTUAR]* Ka patë rast ka qenë nana me ta *[REDAKTUAR]*

PY. Të lutem mos përmendni emra.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mos përmendni emra ju lutem

DËSHMITARI: Vëllai i madh, vëllai i vogël, nana edhe unë

ku jam kanë, po jo në të gjitha ku ka dhanë baba dëshmi. Herë ka qenë i madhi, unë i vogli apo nana.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Shumë e qartë. Këta persona të cilët i përmende a ke diskutuar me ta për dëshminë që ka dhënë babai juaj?

PË. Me cilët persona?

PY. Mamanë, vëllain e vogël, vëllain e madh. A keni diskutuar me babain apo keni diskutuar me njeri tjetër lidhur me dëshminë e babait tuaj?

PË. Jo. S’kemi qenë mrenda dhe nuk e dimë ça ka fol babai. Po për rastin çka ka ndodhë e dimë prej babait. Kur kanë marrë në pyetje ata e kanë marrë mrenda, ne s’na kanë lanë, s’na kanë leju me hi mrend. Për çdo njëni e ka dhënë veçmas.

PY. Pyetja ime z. Dëshmitar është: A ke diskutuar me mamanë, me vëllain e madh apo me vëllain e vogël deklaratat tuaja përpara se të vinit për të dhënë dëshmi këtu në Hollandë?

PË. Jo.

PY. A e keni diskutuar këtë pasi keni arritur në Hollandë?

PË. Për këtë rast, jemi të ditur të gjithë familja. Na ka ardhë thirrja, se unë banoj tash në *[REDAKTUAR]*.

S’po kuptoj unë shka je tuj dashtë apo s’po e kuptoj krejt çka është kjo.

PY. Z. Dëshmitar, ju lutem mos përmendni emra edhe emra vendesh. Kjo nuk ishte pyetja ime, e nderuar Gjykatëse, për z. Dëshmitar, megjithatë përgjigjen e kam marrë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më lejoni një çast që të bisedoj me kolegët e mi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni, z. Avokat i Mbrojtjes.

[Mbrojtja këshillohet]

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, *faleminderit*.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Ne i kemi përfunduar pyetjet tona.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Avokat i Mbrojtjes.

Nuk kemi shumë kohë në dispozicion, megjithatë, më lejohen edhe pak çaste, kështu që po kthehem nga Zyra e ZPS-së nëse dëshirojnë të vazhdojnë me pyetje shtesë për dëshmitarin; dhe, nëse po, sa kohë keni nevojë të keni në dispozicion.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Pikë së pari dua të diskutoj me kolegët e mi, por maksimumi mund të kemi nevojë për pesë ose dhjetë minuta dhe do të kërkonim, në fakt, nëse është mundur që pyetjet tona t'i bëjmë nesër paradite.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk është e mundshme ta bëni sot?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ishte

një pyetje e hapur në fakt. Kemi edhe pak kohë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Një çast, ju lutem.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po dhe sa kohë kemi dhe sa kohë mund të na lejohet?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po shoh orën. Nëse ju duhet kohë të diskutoni dhe të konsultohemi, s'e kemi këtë kohë. Mbase do ishte më mirë që duke pasur parasysh rrethanat është mirë ta shtyjmë. E shoh që keni një farë hezitimi. Sepse kemi ende dhe dy ditë me pyetjet për këtë çështje gjyqësore, në qoftë se është nevoja.

Kështu që po e mbyllim për sot.

Po shoh edhe njëherë Mbrojtësin e Viktimave. A keni ndonjë pyetje ju?

Z. LAWS: [Përkthim] Për momentin, jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E di që është shumë herët për ju.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jam pak i habitur. Ne kemi shumë pak kohë që të përgatisim kundrapyetjet tona pasi mbarojmë pyetjet kryesore dhe ju jepni një mbrëmje të tërë palës tjetër që të përgatitet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po unë kam dhe pesë minuta të mbetura. S'kam më kohë. Kështu që nëse atyre i duhet dhjetë minuta për t'u përgatitur, atëherë kalojmë orarin që më është dhënë mua, më është akorduar mua. Kjo nuk ka lidhje me përgatitjen,. Ka lidhje dhe me disa

rregulla për Trupin Gjykues. Po në qoftë se do të kisha dhe treçerek ore sigurisht që do ta kisha bërë tani.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë këmbëngul dhe po ju them që do ishte shumë mirë që dhe ne të kishim një mbrëmje për të përgatitur kundrapyetjet tona. Këtë doja të vija në dukje unë. Nuk po ju qortoj. Është një parashtrim dhe për mua është e habitshme që ju e jepni këtë kohë dhe do të doja që ta kishit parasysh këtë gjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat, po shpjegoni pse habiteni ju. Unë ju dhashë fjalën shpjegojeni për çfarë u habitët ju kaq shumë.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Është normale që ne t'i bëjmë kundrapyetjet menjëherë pasi mbarojnë pyetjet kryesore. Dhe tani jemi në një situatë, jemi përballë një fakti tani, ku kolegët përballë meje kanë një mbrëmje të tërë për të përgatitur dhe mua kjo më habit, nuk janë ata në gjendje ta bëjnë tani dhe ne duhet të presim, kjo është normale. Më krijohet përshtypja se nuk po trajtohemi në mënyrë të barabartë, nuk është e barabartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më lejoni t'ju përgjigjem.

Trupi Gjykues për të mos vazhduar tani vjen për shkak se ZPS-ja tha se i duhen pesë ose dhjetë minuta kohë. Dhe po ashtu na bënë me dije se i duhet pak kohë për t'u konsultuar. Dhe pashë orën dhe kuptova se kështu do të kalonim orarin që

më ka akorduar NJAGJ-ja për të vazhduar me këtë seancë. Dhe ky është një rregull i artë.

Nuk po i jap ZPS-së më shumë mundësi, më shumë shanse seç i jap Mbrojtjes, por ka disa rregulla logjistike organizative dhe duhet t'i respektojmë këto rregulla.

Andaj ky është shpjegimi pse do të veprojmë kështu sot dhe nuk janë arsyet që po sugjeroni ju, të cilat i mendoni ju. Kemi kufizime logjistike, prandaj dolëm me këtë vendim.

Avokat, a mund t'ju bëj dhe një pyetje tjetër. Unë nuk ju dëgjova ta pyesnit Trupi Gjykues ose t'i kërkonit Trupit Gjykues që t'ju jepnim më shumë kohë. Nuk na e keni kërkuar. Dhe as nuk ua ka refuzuar këtë kërkesë Trupi Gjykues.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, në fakt, nuk e kemi kërkuar këtë. Do ta bëjmë. Sigurisht. Zakonisht ne detyrohemi ta bëjmë. Është krejt normale. Prandaj u habita pak. Sepse është shumë thjeshtë të thuash po ose jo edhe pse ka ngelur pesë minuta kohë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, po nuk ishte kjo pyetja ime. Unë ju pyeta a keni kërkuar ndonjëherë ju leje nga Trupi Gjykues në ndonjë moment që të keni më shumë kohë për përgatitjen dhe ne nuk ua dhamë këtë kohë? Po ju s'na e keni kërkuar asnjëherë shtesë kohe. Prandaj unë s'po e kuptoj këtë. Se ju po nënkuptoni që ne nuk jemi sjellë njësoj dhe ndjej nevojën ta shpreh këtë. Unë nuk kam qenë ndonjëherë në pozita që t'ju jap më shumë kohë se s'ma

keni parashtruar ndonjëherë këtë kërkesë.

Z. GILISSEN: [Përkthim] E vlerësoj shumë këtë që sapo thatë. Do ta kem parasysh. Të drejtë keni asnjëherë s'e kemi kërkuar kohën shtesë. Shumë e drejtë. Qëndron kjo që thatë ju.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, unë dua ta bëj të qartë sepse mu krijua përshtypja, pata një ndjesi sikur nënkuptuat diçka.

Unë dua ta bëj të qartë që këtu jemi për të dyja palët, për Mbrojtësin e Viktimave dhe duam t'ju japim të gjithëve mundësinë që të paraqesin provat e tyre në mënyrën sesi ata dëshirojmë, sigurisht, duke pasur parasysh një zhvillim efikas dhe të drejtë të procesit gjyqësor. Kështu që në çdo moment mund t'i trajtoheni Trupit Gjykues të kërkoni më shumë kohë dhe ne do të vendosim si Trupi Gjykues nëse do t'ua japim apo jo këtë kohë. Të jetë kjo e qartë.

Edhe kjo që vendosëm për sot erdhi për shkak të asaj, që unë e kam thënë tre herë tashmë, për shkak të kufizimeve logjistike.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbase nuk e kisha për Trupin Gjykues, unë e kisha për kolegët këtë reflektim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Qartë.

Jemi në seancë publike. Do i lutesha Asistentes së Gjykatës të shoqërojë dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

Z. Dëshmitar, do të takohemi nesër bashkë. Faleminderit

për përpjekjet e ditës së sotme. Nuk duhet ta diskutoni dëshminë që keni dhënë sot në sallën e gjyqit me askënd dhe urojmë një pasdite të këndshme dhe të pushoni

DËSHMITARI: Faleminderit, gjithashtu.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Patëm një ditë të gjatë. Falënderoj të gjitha palët dhe pjesëmarrësit për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre, në çdo aspekt. I faleminderit sigurisë dhe përkthyesve edhe stenografes. Kemi punuar shumë sot.

Seanca mbyllet, takohemi nesër në orën 9.30.

--- Seanca mbyllet në orën 16.23